



**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

DREJTORIA E KURRIKULËS DHE E KUALIFIKIMIT

MODELE TESTESH PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

(Teste të hartuara nga mësuesit)

LËNDA “HISTORI”



TETOR, 2019

ARSIMI FILLOR (AF)

LËNDA: HISTORI

KLASA: IV

SHKOLLA: ARDIAN KLOSI

MËSUES: GJERGJI VANGJELI

TEST PËR PERIUDHËN E PARË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematikat (Konceptet)	Pikë	Rezultatet e të nxënit	Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Historia ime dhe e familjes sime – <i>Burime të thjeshta historike</i> – <i>Data dhe ngjarje të rëndësishme personale dhe familjare</i> – <i>Pema e familjes</i> – <i>Linja e kohës</i> – <i>Llogaritja e kohës</i> – <i>Aspekte të jetës familjare të njerëzve në të kaluarën</i> – <i>Ndryshime në mënyrën e jetesës së familjes(sot me të kaluarën)</i>	29 pikë	<i>Nxënësi:</i> – kërkon për të shkuarën nga një sërë burimesh historike dhe informacioni; – përdor burime apo dëshmi të thjeshta historike nga jeta personale dhe familjare si: fotografi, lodrat e tyre të para, libri i parë që kanë lexuar etj.; – ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike; – ndërton pemën e familjes së tij; – përdorë saktë datat dhe fjalorin për periudha të ndryshme historike; – kryen veprime të thjeshta për llogaritjen e kohës;	11 pikë P.1 P.5 P.7 P.8 P.11	13 pikë P.2 P.4 P.9	5 pikë P.3 P.6

		– dallon ndryshimet dhe shembujt e vazhdimësisë në jetën e prindërve dhe gjyshërve në veshje, ushqim, libra, lojëra, aktivitetet e kohës së lirë, komunikacion; – kryen llogaritje të thjeshta të kohës për ngjarje personale ose familjare;			
Lojërat, argëtimet, festat dhe festimet	2 pikë	– tregon lojëra dhe argëtime që pëlqeheshin dhe luheshin nga prindërit e gjyshërit në të kaluarën.	2 pikë P.10		

KLASA: IV

SHKOLLA: ARDIAN KLOSI

MËSUES: GJERGJI VANGJELI

PERIUDHA E PARË

1. Albani shkroi disa fjali për historinë e familjes. Shëno me **V** fjalitë e sakta dhe me **G** ato të pasakta. **3 pikë**

- a) Historia e familjes më tregon ngjarje të brezave paraardhës _____
- b) Historia e familjes më tregon për të ardhmen e familjes sime _____
- c) Historia e familjes më mëson të krijoj identitetin tim _____


2. Në dhomën e tij Albani ruan shumë kujtime si: lodrën e parë, vjershën që ka krijuar për herë të parë si dhe shumë albume me fotografi të familjes. **3 pikë**

Shëno me + në kolonën e duhur llojin e burimit për kujtimet e Albanit.

Kujtimet e Albanit	Burim material	Burim i shkruar	Burim figurativ
Lodra e parë			
Vjersha e parë			
Fotografia e stërgjyshit			

3. Në një fletore Albani ka shënuar vitet më të rëndësishme të jetës së tij. Ndihmoje Albanin t'i vendosë ato në vijën e kohës më poshtë. **4 pikë**

- a) Viti 2015- filloi klasën e parë;
- b) Viti 2018- mbushi 10 vjeç;
- c) Viti 2011- shkoi në kopsht;
- d) Viti 2008 – viti i datëlindjes.



4. Shkruaj dy data të rëndësishme për historinë e familje tënde. Trego pse janë të rëndësishme. **4 pikë**

- a) _____

b) _____

5. Babai i ka treguar Albanit se ai ka jetuar në fshat, nga viti 1968 deri në vitin 1998. Sa vite ka jetuar në fshat babai i Albanit? Qarkoni alternativën e saktë. **1 pikë**

A. 20 vjet
B. 30 vjet
C. 40 vjet
D. 50 vjet

6. Albani ka mësuar nga gjyshi se familja patriarkale ka pasur deri në 20 anëtarë. Kush e luante rolin e kryetarit në këtë familje? **1 pikë**

A. Gjyshja
B. Gjyshi
C. Babai
D. Mamaja

7. Në mur Albani ka vendosur pemën e familjes së tij. Për çfarë është e rëndësishme ajo?

1 pikë

A. Për të njohur shokët e Albanit
B. Për të njohur pasardhësit e Albanit
C. Për të njohur paraardhësit e Albanit
D. Për të njohur komshinjtë e Albanit

8. Historianët e ndajnë kohën me periudha të mëdha. Lidh me shigjetë periudhat me vitet përkatëse. **3 pikë**

Dekada	100 vite
Shekulli	10 vite
Mijëvjeçari	1000 vite

9. Plotëso fjalitë me fjalët dhe grupet e fjalëve të dhëna më poshtë:

6 pikë

familje të vogla, punët e shtëpisë, të moshuarit, familje të mëdha, me kompjuter, ndihmojnë njëri-tjetrin, me rrasa.

Stërgjyshërit tanë jetonin në_____. Në këto familje gratë merreshin me_____.Ato duhet të zbatonin atë që u thoshin më_____. Fëmijët më parë luanin lojëra si: _____, tris, etj. Ndërsa sot njerëzit jetojnë në_____. Burri dhe gruaja _____ për edukimin e fëmijëve.

10. Shkruaj emrat e dy lojërave popullore që ti luan sot.


2 pikë

a) _____

b) _____

11. Plotëso skemën e pemës së familjes tënde.

3 pikë



Skema e vlerësimit

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 7	8 - 11	12 - 15	16 - 19	20 - 23	24 - 27	28 – 31

LËNDA: HISTORI

KLASA: IV

SHKOLLA: ARDIAN KLOSI

MËSUES: GJERGJI VANGJELI

TEST PËR PERIUDHËN E TRETË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematikat (Konceptet)	Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Zona dhe vendi im – <i>Objektet historike, kulturore</i> – <i>Ngjarje të rëndësishme historike</i> – <i>Figurat historike</i> – <i>Simbolet kombëtare</i> – <i>Institucione publike</i> – <i>Trashëgimi e mbrojtur</i> – <i>Shqiptarë të famshëm</i>	31 pikë	Nxënësi: – përcakton objektet më të rëndësishme kulturore dhe historike të zonës me vlera kombëtare e më gjerë; – përshkruan ngjarje të rëndësishme në historinë e zonës me impakt në historinë kombëtare; – dallon simbolet kombëtare dhe përshkruan origjinën e tyre; – dallon disa nga institucionet e rëndësishme të zonës dhe vendit: (parlamenti, kryeministria, ministritë, komuna ose bashki, teatri, muzeu, banka, qendra shëndetësore, posta etj.);	13 pikë P. 1 P.2 P.3 P.6 P.12	10 pikë P.4 P.7 P.9 P.10	8 pikë P.5 P.8 P.11

		– identifikon dhe vlerëson rolin e shqiptarëve të shquar në botë; – dallon dhe vlerëson vendin që zë trashëgimia jonë kulturore në trashëgiminë kulturore botërore; (Butrinti, Berati, Gjirokastra, Polifonia labe, trashëgimi e mbrojtur nga UNESCO); – kupton vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli.			
--	--	--	--	--	--

LËNDA: HISTORI

KLASA: IV

SHKOLLA: ARDIAN KLOSI

MËSUES: GJERGJI VANGJELI

PERIUDHA E TRETË

1. Albani së bashku me familjen e tij ka marrë pjesë në festën madhështore në kujtim të 100-vjetorit të Pavarësisë në Vlorë. Cila nga datat e mëposhtme është data e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë? **1 pikë**

Qarkoni alternativën e saktë.

- A. 29 Nëntor 1912
- B. 28 Nëntor 1912
- C. 26 Nëntor 1912
- D. 25 Nëntor 1912

2. Gjatë vizitës në shtëpinë muze ku u ngrit flamuri në Vlorë, Albani mësoi më shumë për figurën historike të patriotit që udhëhoqi shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Cili ishte ai? **1 pikë**

Qarkoni alternativën e saktë.

- A. Çerçis Topulli
- B. Mihal Grameno
- C. Ismaili Qemali
- D. Bajram Curri

3. Një fundjavë, gjyshi e çoi Albanin për vizitë në Muzeun Kombëtar. Rugës për në muze, ai i tregoi shumë ndërtesa të rëndësishme shtetërore si: kuvendin e Shqipërisë, kryeministrinë, bashkinë e Tiranës, si dhe objekte të tjera social-kulturore të tilla si: bibliotekën kombëtare, galerinë e arteve etj.. Plotëso tabelën me institucionet dhe objektet që gjyshi i tregoi Albanit.

6 pikë

Institucione të rëndësishme të shtetit shqiptar	Objekte social - kulturore	Objekte historiko-kulturore
---	----------------------------	-----------------------------

1 _____	1 _____	1 _____
2 _____	2 _____	
3 _____		

4. Gjatë vizitës në muzeun kombëtar, Albani u njoh me luftën historike të popullit tonë nga viti 1443 deri në vitin 1468 përballë pushtimit osman nën udhëheqjen e Skënderbeut. Trego sa vite zgjati kjo luftë. **1 pikë**
- A. 20 vite
B. 25 vite
C. 30 vite
D. 35 vite
5. Në muze, Albani pa shumë mjete luftarake që janë përdorur gjatë luftës kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë deri në datën e çlirimit. Cila është data e çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit gjermanë? **1 pikë**
- A. 28 Nëntor 1944
B. 29 Nëntor 1944
C. 27 Nëntor 1944
D. 30 Nëntor 1944
6. Për hapjen e shkollës së parë shqipe ndihmuan shumë patriotë shqiptarë. Cili ishte një nga mësuesit e shkollës së parë shqipe? **1 pikë**
- A. Sami Frashëri
B. Naim Frashëri
C. Petro Nini Luarasi
D. Ismail Qemali
7. Me formimin e shtetit shqiptar u krijuan edhe simbolet kombëtare. Shkruani cilat janë ato. **3 pikë**
- a) _____

- b) _____
- c) _____

8. Në listën e vendeve të trashëgimisë botërore të UNESCO janë përfshirë disa qytete të vendit tonë. Shkruani cilat janë këto qytete. **3 pikë**

- a) _____
- b) _____
- c) _____

9. Shoqëria shqiptare ka trashëguar nga e kaluara një thesar të vërtetë kulturor si: legjenda e Mujit dhe Halilit, kostume popullore, valle popullore, ritet e dasmave, kështjella e Gjirokastrës etj.. Ndaje këtë thesar sipas llojit të trashëgimisë kulturore. **5 pikë**

Trashëgimi kulturore materiale	Trashëgimi kulturore jo materiale
1 _____	1 _____
2 _____	2 _____
	3 _____

10. Një nga elementët e trashëgimisë kulturore është Polifonia Labe. Qarko zonën ku këndohet ajo. **1 pikë**

- A. Zonën e Korçës
- B. Zonën e Shkodrës
- C. Zonën e Tropojës
- D. Zonën e Labërisë

11. Albani ka vizituar objekte historike në disa qytete të vendit tonë. Lidh me shigjetë objektin historik me qytetin përkatës. **5 pikë**

Kalaja e Rozafës

Korçë

Mësonjëtorja e parë shqipe

Shkodër

Shtëpia muze e Ismail Kadaresë

Berat

Ura e Tabakëve

Gjirokastrë

12. Në qytetin apo fshatin tënd ndodhen shumë institucione që luajnë një rol të rëndësishëm për jetën e njerëzve. Plotëso vendin bosh me emrin e duhur të institucionit. **3 pikë**

- a) _____ është institucion që kujdeset për shëndetin tonë.
- b) _____ ruan rendin dhe qetësinë e qytetarëve.
- c) _____ çon një letër nga një vend në një vend tjetër.

Skema e vlerësimit

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 7	8 - 11	12 - 15	16 - 19	20 - 23	24 - 27	28 – 31

LËNDA: HISTORI

KLASA: V

SHKOLLA: ARDIAN KLOSI

MËSUES: GJERGJI VANGJELI

TEST PËR PERIUDHËN E DYTË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematikat <i>(Konceptet)</i>	Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Shoqëritë e para njerëzore – <i>Njerëzit e parë dhe shoqëria njerëzore në parahistori</i> – <i>Tipare të jetës së shoqërisë njerëzore nga epoka e gurit në epokën e hekurit</i> – <i>Evolucioni i kulturave të hershme në territoret shqiptare</i> – <i>Shpikje të rëndësishme që çuan përpara zhvillimin e njerëzimit</i> – <i>Roli i gruas në parahistori</i>	31 pikë	Nxënësi: – tregon për njerëzit e parë dhe shoqërinë njerëzore në parahistori; – tregon faktorët që ndikuan në zhvillimin e shoqërive të hershme; – tregon veprimtaritë e para ekonomike, zhvillimin e mendimit, të besimit e të artit dhe të komuniteteve të hershme njerëzore, si pikënisje e qytetërimeve botërore; – dallon ndryshimet në mënyrat e jetesës së shoqërisë njerëzore, nga epoka e gurit në atë të hekurit;	12 pikë P.3 P.6 P.7 P.9	12 pikë P.1 P.4 P.11	7 pikë P.2 P.5 P.8 P.10

– <i>Arti, besimi, kultura e njerëzve në lashtësi</i>		– përshkruan epërsitë që solli ndarja e punës dhe përdorimi i metaleve në zhvillimin e shoqërisë njerëzore; – përcakton gjurmë të parahistorisë në territoret shqiptare si: vendbanimet përfaqësuese të kësaj periudhe; – përshkruan rolin e gruas në zhvillimin e shoqërisë njerëzore.			
--	--	--	--	--	--

LËNDA: HISTORI

KLASA: V

SHKOLLA: ARDIAN KLOSI

MËSUES: GJERGJI VANGJELI

PERIUDHA E DYTË

1. Duke u bazuar në materialin kryesor me të cilin njerëzit e parë ndërtonin veglat e punës, arkeologët dhe historianët e kanë ndarë historinë e njerëzimit në tri kohë. Cilat janë këto tri kohë? **3 pikë**

- a) _____
b) _____
c) _____

2. Mësuesja ju ka mësuar se periudha më e gjatë e shoqërisë njerëzore është parahistoria e cila ndahet në tri periudha. Lidh çdo periudhë me kohën përkatëse. **3 pikë**

Paleoliti	8000 vite deri 6000 vite para Krishtit
Mezoliti	3 milionë deri 8000 vite para Krishtit
Neoliti	6000 vite deri 3000 vite para Krishtit

3. Plotëso vendet bosh në fjali me fjalët e dhëna më poshtë: **5 pikë**
ushtat dhe thikat; të mbuluar me qime; hominidë; 2 milionë vite; në kope; harku dhe shigjetat.
Paraardhësit tanë më të largët quhen _____. Ata janë shfaqur _____ më parë. Trupin e kishin të kërrusur dhe të _____. Jetonin _____ dhe ushqeheshin me fruta, rrënjët e bimëve dhe mishin e kafshëve të kapura. _____ prej guri ose kocke ishin veglat dhe armatimet e tyre.

4. Pas përdorimit të zjarrit dhe jetesës në shpella e kasolle, filloi, ndarja e punëve ndërmjet burrit dhe gruas. Plotëso tabelën e mëposhtme me punët që merrej secili. **6 pikë**

Punët që bënte gruaja	Punët që bënte burri
-----------------------	----------------------

1 _____	1 _____
2 _____	2 _____
3 _____	3 _____

5. Metali i parë që u zbulua rreth 4000 vite para Krishtit ishte: **1 pikë**

- A. Hekuri
- B. Bronzi
- C. Bakri
- D. Kallaj

6. Në periudhën e neolitit, te paraardhësit tanë lindën edhe mënyrat e para të besimit. Shkruaj emrat e fuqive në të cilat ata besonin më shumë. **3 pikë**

- a) _____
- b) _____
- c) _____

7. Njerëzit e lashtë e pëlqenin të bukurën dhe filluan të krijonin vetë gjëra të bukura. Kështu lindi: **1 pikë**

- A. Gjuha
- B. Besimi
- C. Arti
- D. Tregtia

8. Pas zbulimit të metaleve, rreth viteve 4000 – 1100 para Krishtit lindën degë të reja të ekonomisë. Cilat ishin këto degë? **2 pikë**

- a) _____
- b) _____

9. Shëno me **V** fjalitë e sakta dhe me **G** ato të pasakta.

3 pikë

- a) Grumbullimi i disa gjinive në luginat e lumenjve bëri që të krijoheshin fiset. _____
- b) Territori shqiptar ka filluar të popullohet që para 100000 vjetësh. _____
- c) Punët e blegtorisë dhe punimi i tokës me parmendë bëhej nga gratë. _____

10. Në periudhën e neolitit, banorët për të jetuar ndërtonin palafite mbi ujë. Në cilën zonë të territorit shqiptar janë gjetur gjurmët e tyre nga arkeologët?

1 pikë

- A. Në Xarë të Sarandës
- B. Apoloni të Fierit
- C. Gajtan të Shkodrës
- D. Maliq të Korçës

11. Rreth 500000 vite më parë njerëzit primitivë filluan të përdorin zjarrin. Shkruani tre faktorë të rëndësisë së tij që çuan në përmirësimin e jetës së njerëzve të lashtë.

3 pikë

Skema e vlerësimit

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 7	8 - 11	12 - 15	16 - 19	20 - 23	24 - 27	28 - 31

LËNDA: HISTORI

KLASA: V

SHKOLLA: ARDIAN KLOSI

MËSUES: GJERGJI VANGJELI

TEST PËR PERIUDHËN E TRETË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematikat <i>(Konceptet)</i>	Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Qytetërimet antike, themeli i kulturës evropiane – <i>Koha dhe hapësira e lindjes së qytetërimeve antike</i> – <i>Tipare të përgjithshme të qytetërimeve antike</i> – <i>Qytetërimi ilir</i> – <i>Trashëgimia e qytetërimeve antike sot</i> – <i>Zhvillimi i shkencës në antikitet</i> – <i>Figura historike që kanë</i>	31 pikë	Nxënësi: – përcakton konceptin qytetërim; – përcakton kohën dhe faktorët që çuan në lindjen e qytetërimeve antike; – përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimeve antike; – përshkruan tipare të përgjithshme të zhvillimit ekonomike–shoqëror në botën antike; – përshkruan karakteristikat e jetës së përditshme në Iliri, si: veshja, ushqimi, mobilimi i shtëpive, martesat, zakonet, arsimi; artin dhe besimin e tyre etj.; – tregon monumentet më të rëndësishme kulturore të	12 pikë P. 1 P. 2 P. 5 P. 6	11 pikë P. 4 P. 7 P. 8	8 pikë P.3 P.9

<i>kontribuar në zhvillimin e qytetërimeve antike</i>		antikitetit si pjesë e trashëgimisë kulturore botërore sot, përfshirë edhe qytetërimin në vendin tonë; – vlerëson arritjet e shkencës në zhvillimin e qytetërimeve botërore; – përmend disa nga figurat historike që kanë kontribuar në fusha të ndryshme për zhvillimin e qytetërimeve antike.			
--	--	---	--	--	--

LËNDA: HISTORI
KLASA: V
SHKOLLA: ARDIAN KLOSI
MËSUES: GJERGJI VANGJELI
PERIUDHA E TRETË

1. Plotëso fjalitë me fjalët e dhëna më poshtë: **5 pikë**

barbari, qytetërimi, e prapambetur, e përparimeve, jeta e njerëzve.

_____ është një shkallë më e lartë se jeta primitive të cilët historianët e quajnë _____. Në barbari _____ ishte _____ kurse qytetërimi lindi si pasojë _____ në ekonomi, shoqëri, qeverisje, kulturë dhe besim.

2. Shëno me **V** fjalitë e sakta dhe me **G** ato të pasakta. **3 pikë**

Qytetërimet e para lindën në Azinë jugore, rreth 3000 vite para Krishtit _____

Në Europën jugore, qytetërimet lindën rreth 2000 vite para Krishtit _____

Në Amerikë, qytetërimet lindën 1000 vite para Krishtit. _____

3. Luginat e lumenjve në kontinentet e Afrikës dhe të Azisë, u krijuan territoret e para ku lindën qytetërimet e para. Lidh me shigjetë, luginat e lumenjve me qytetërimet që lindën pranë tyre.

4 pikë

Nili	Indi
Ind dhe Gang	Egjypt
Tigër e Eufrat	Kinë
Huanhe	Mesopotamia

4. Qytetërimet e para në Europë lindën në brigjet e detit: **1 pikë**

- A. Adriatik
- B. Jon
- C. Mesdhe
- D. Tiren

5. Rreth 2400 vite më parë ilirët krijuan mbretëritë e tyre. Cili ishte mbreti i parë ilir? **1 pikë**

- A. Pirroja
- B. Bardhyli
- C. Agroni
- D. Aristoteli

6. Plotëso: **3 pikë**

Kultura ilire pati ndikime nga vendet fqinjë, por ata përsëri ruajtën në shekuj tiparet e tyre të veçanta si: _____, _____ dhe _____ e tyre.

7. Në qytetërimet e lashta morën zhvillim shkencat e natyrës dhe ato shoqërore si: matematika, historiografia, filozofia, astronomia, teatri. Plotëso tabelën e mëposhtme me shkencat që morën zhvillim sipas vendeve përkatëse. **5 pikë**

Në vendet e Lindjes së lashtë	Në Greqi dhe Romë
1 _____	1 _____
2 _____	2 _____
	3 _____

8. Në lashtësi u dalluan shumë personalitete në zhvillimin e kulturës dhe të shkencës, veprat e të cilëve kanë rëndësi dhe sot. Lidh me shigjetë figurat historike me fushat përkatëse. **5 pikë**

Homeri	Filozofi
Pitagora	Mjekësi
Aristoteli	Letërsi
Hipokrati	Matematikë
Herodoti	Histori

9. Në qytetërimet e lashta, si në Lindjen e lashtë ashtu dhe në Greqi e Romë, janë krijuar e ndërtuar shumë monumente me rëndësi kulturore dhe historike. Lidh me shigjetë emrat e monumenteve me figurat dhe vendet përkatëse. **4 pikë**

Piramida e Keopsit



Romë

Koloseu



Egjipt

Kolosi i Rodosit



Greqi

Fari i Aleksandrisë



Kinë

Skema e vlerësimit

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 7	8 - 11	12 - 15	16 - 19	20 - 23	24 - 27	28 - 31

ARSIMI I MESEM I ULËT (AMU)

LËNDA: HISTORI

KLASA: VI

SHKOLLA: KUSHTRIMI I LIRISË

MËSUES: NAJADA HOXHA

TEST PËR PERIUDHËN E DYTË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematika dhe Koncepte	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Manastire	3% 1 pikë	Nxënësi: identifikon rolin e manastireve në mesjetë;	1	0	0
Kryqëzata	11% 3 pikë	identifikon organizimin e kryqëzatave dhe tregon pasojat e tyre;	1	2	0
Perandoria Bizantine	7% 2 pikë	dallon rolin perandorit në Perandorinë Bizantine dhe trashëgiminë e saj;	1	1	0
Figura historike	14% 4pikë	përshkruan Justinianin si perandori që solli ndryshime të mëdha në Perandorinë Bizantine dhe vlerëson figurën e tij;	1	3	0
Kronologji	14% 5 pikë	përcakton kohën kur u kurorëzua perandor Karli i Madh, kur u	3	2	0

		krijua Principata e Arbrit, lulëzoi kultura arabe, lindi tregtia ndërkombëtare dhe lindi sistemi feudal;			
Sistemi feudal	7% 2 pikë	përcakton dy tiparet thelbësore që dallojnë sistemin feudal;	2	0	0
Struktura shoqërore	18% 5 pikë	përcakton strukturën shoqërore në Europën Mesjetare;	0	0	5
Punë angari, vasal, islamizëm	10% 3 pikë	shpjegon konceptet punë angari, vasal, islamizëm;	1	2	0
Qytetërim arab	7% 2 pikë	përcakton dy nga arritjet e qytetërimit arab;	2	0	0
Paraja dhe shkëmbimi me monedha	7% 2 pikë	ndërton pyetje për paranë dhe formën e re të shkëmbimit, nisur nga paragrafi i dhënë.	0	2	0
Pikët total të testit	100% 29 pikë		40% 12 pikë	40% 12 pikë	20% 5 pikë

LËNDA: HISTORI

KLASA: VI

SHKOLLA: KUSHTRIMI I LIRISË

MËSUES: NAJADA HOXHA

PERIUDHA E DYTË

1. Gjatë periudhës së Mesjetës në Europë lindën, shtete e perandori. Në periudhën e lulëzimit të tyre pësoi zhvillim ekonomia, arti, kultura e shkenca. Me lindjen e islamit filluan konfliktet fetare. Në fjalitë e mëposhtme vendosni “V” për pohimet e vërteta dhe “G” për pohimet e gabuara. **4 pikë**

Pohimi	E vërtetë	E gabuar
Manastiret ishin qendra arsimore e kulturore.		
Justiniani forcoi shtetin duke miratuar ligje që rregullonin jetën politike, shoqërore, ekonomike.		
Kryqëzatat ishin ekspedita ushtarake të organizuara nga mbreti		
Perandoria bizantine nuk e ruajti trashëgiminë greko-romake.		

2. Në krye të Perandorisë qëndronin perandorët të cilët bënë luftëra, shpallnin paqen, miratonin ligje, krijonin institucione, etj. Ata vendosnin për gjithçka në perandori dhe mendonin se ky pushtet ju buronte nga zoti. Perandori në Perandorinë Bizantine konsiderohej: **1 pikë**
- A) Funkionar i lartë i shtetit
B) Nëpunës i lartë ushtarak
C) Kreu i Kishës Ortodokse
D) Kreu i pushtetit shtetëror dhe fetar
3. Pas rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit, në territoret e saj u krijuan shtetet romano-gjermane. Njëri prej tyre ishte ai i frankëve që arriti kulmin në kohën e Karlit të Madh. Papa Leoni III e kurorëzoi Karlin perandor në vitin: **1 pikë**

- A) 800
- B) 801
- C) 802
- D) 803

4. Në Mesjetë, tregtia në Europën Perëndimore njohu zhvillim të madh. U krijuan rajonet tregtare. Tregtia filloi të zhvillohej edhe mes rajoneve tregtare, pra po krijohej tregtia ndërkombëtare. Kjo tregti i ka fillesat në shekujt:

1 pikë

- A) XI-XII
- B) XIII-XIV
- C) XV-XVI
- D) XVII-XVIII

5. Ngjarjet e mëposhtme renditi sipas kohës kur kanë ndodhur.

3 pikë

Krijohet Principata e Arbrit; Lulëzoi Kultura arabe; Lindi Sistemi Feudal.

- a) _____
- b) _____
- c) _____

6. Perandoria Bizantine arriti lulëzimin e saj në kohën kur në krye të saj ishte perandori Justinian. Gjatë sundimit të tij, Perandoria Bizantine pësoi ndryshime të mëdha në të gjitha drejtimet. Përshkruaj figurën e Perandorit Justinian duke evidentuar ndryshimet.

3 pikë

7. Në thelb të marrëdhënieve shoqërore, gjatë periudhës së mesjetës ishin marrëdhëniet feudale. Përcakto dy tiparet themelore të sistemit feudal.


2 pikë

- a) _____

b) _____

8. Në Mesjetë njerëzit jetonin në qytete por edhe në fshatra. Popullsia ishte e ndarë në shtresa. Plotëso skemën duke përcaktuar elementët që përbëjnë strukturën shoqërore në Europën Mesjetare.

5 pikë



9. Sistemi feudal dallonte nga ai skllavopronar. Në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të VII në gadishullin Arabik, lindi një fe e re. Shpjego kuptimin e koncepteve/termave të mëposhtme:

3 pikë

- a) Punë angari: _____
- b) Vasal: _____
- c) Islamizëm _____

10. Gjatë shekujve X-XII dallimet mes qytetërimit perëndimor dhe atij lindor u thelluan. Papa i Romës, organizoi 8 fushata ushtarake që u quajtën kryqëzata, të cilat dështuan. Evidento dy nga pasojat e kryqëzatatave.

2 pikë

- a) _____
- b) _____

11. Qytetërimi arab lindi dhe u zhvillua në Gadishullin Arabik. Në krye të shtetit arab qëndronte Kalifi. Nën sundimin e kalifëve bota arabe njohu një periudhë të madhe lulëzimi. Shkruaj dy nga arritjet e qytetërimit arab.

2 pikë

- a) _____
- b) _____

12. Lexo paragrafin e mëposhtëm dhe harto dy pyetje.

2 pikë

“Qytetet ndikuan edhe në jetën e fshatit. Shkëmbimi mall me mall, filloi t’ia lërë vendin shkëmbimit me monedha. Lindi paraja. Feudali filloi t’ia kërkonte bujkrobit një pjesë të detyrimeve në të holla.”

Pyetja 1. _____

Pyetja 2. _____

Skema e vlerësimit

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-6	7-10	11-14	15-18	19-22	23-26	27-29

LËNDA: HISTORI

KLASA: VII

SHKOLLA: KUSHTRIMI I LIRISË

MËSUES: NAJADA HOXHA

TEST PËR PERIUDHËN E DYTË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematika dhe Koncepte	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Iluminizëm, nacionalizëm, romantizëm	13% 4 pikë	Nxënësi: përcakton tiparet e iluminizmit, nacionalizmit dhe romantizmit;	0	4	0
Monarki absolute, monarki parlamentare	13% 4 pikë	bën dallimin mes monarkisë absolute dhe asaj parlamentare;	4	0	0
Akti mbi të Drejtat e Njeriut	7% 2 pikë	përkruan ndryshimet që solli Akti mbi të Drejtat e Njeriut në shoqërinë angleze;	0	2	0
Lufta Civile	3% 1pikë	evidenton kohën kur u zhvillua Lufta Civile në SHBA;	1	0	0
Revolucion Industrial	9% 3 pikë	evidenton ndonjë nga vlerat e revolucionit industrial;	3	0	0
Feudalizmi	3% 1pikë	përcakton një nga vendimet e rëndësishme të asamblesë kushtetuese në Francë;	0	1	0

Shkaqet e Revolucionit në Perandorisë Austriake	7% 2 pikë	evidenton shkaqet e revolucionit në perandorinë austriake;	2	0	0
Shtet autonom dhe shtet i pavarur	13% 4 pikë	bën dallimin mes shtetit autonom dhe atij të pavarur;	0	4	0
Lëvizje kombëtare	7% 2 pikë	përcakton detyrat që kishin lëvizjet kombëtare;	2	0	0
Napoleon Bonaparti	13% 4pikë	vlerëson figurën e Napoleon Bonapartit;	0	0	4
Restaurimi	7% 2pikë	përcakton ndryshimet që solli Kongresi i Vjenës;	0	0	2
Platforma “Greqia e madhe” dhe “Naçertania”	3% 1pikë	evidenton tiparin e përbashkët të platformave “Greqia e Madhe” dhe “Naçertania”;	0	1	0
Libri i kuq	3% 1 pikë	përcakton një nga kërkesat e kuvendit të Greçës.	0	1	0
Pikët total të testit	100% 31 pikë		40% 12 pikë	40% 13 pikë	20% 6 pikë

LËNDA: HISTORI

KLASA: VII

SHKOLLA: KUSHTRIMI I LIRISË


MËSUES: NAJADA HOXHA

PERIUDHA E DYTË

1. Nga 25 milionë banorë që kishte Franca, 23 milionë jetonin në fshat. Fshatarët ishin njerëzit më të shtypur dhe më të varfër. Ata paguanin taksa e detyrime ndaj shtetit, kishës dhe fisnikëve. Më 11 gusht 1789 Asambleja Kushtetuese në Francë shpalli me ligj: **1 pikë**
 - A) Vendosjen e feudalizmit
 - B) Vendosjen e kapitalizmit
 - C) Heqjen e feudalizmit
 - D) Heqjen e kapitalizmit

2. Në vitin 1850, SHBA ishte një nga shtetet më të mëdha të botës. Mes pjesës veriore dhe jugore të saj kishte ndryshime të mëdha. Në Veri ishte zhvilluar industria, komunikacioni e tregtia ndërsa në Jug, ishte e zhvilluar bujqësia dhe skllavëria zezake. Mosmarrëveshjet mes tyre çuan në shpërthimin e luftës civile që u zhvilluan në vitet: **1 pikë**
 - A) 1861-1865
 - B) 1862-1866
 - C) 1863-1867
 - D) 1864-1868

3. Revolucioni grek, filloi në vitin 1821 dhe mbaroi në vitin 1829 dhe solli pavarësinë e shtetit grek. Ndërsa në vitin 1830, Fuqitë e Mëdha e njohën Serbinë shtet të pavarur. Plotëso skemën duke vendosur tiparin e përbashkët të programeve/projekteve “Naçertania” dhe “Greqia e Madhe”. **1 pikë**



4. Në fillim të shekullit të XX shqiptarët ndodheshin nën sundimin Osman. Ata ndihmuan Turqit e Rinj të vinin në pushtet, ngaqë ata kishin premtuar se do ti plotësonin interesat e tyre kombëtare. Në “Librin e kuq” u shkrua kërkesa për: **1 pikë**

- A) Krijimin e shtetit të pavarur shqiptar
- B) Krijimin e shtetit autonom shqiptar
- C) Krijimin e qeverisë së shtetit shqiptar
- D) Krijimin e ushtrisë së shtetit shqiptar

5. Në shek. XIV-XV në pjesën më të madhe të shteteve të Europës, forma e qeverisjes ishte monarki absolute. Në shek. XVI-XVII disa prej tyre fillojnë të marrin formën e monarkive parlamentare. Plotëso fjalitë duke vendosur termat/konceptet e mëposhtme: **4pikë**
- monarki absolute; Angli; parlament; Francë; mbret; monarki parlamentare.*

Format e qeverisjes në _____ ishte monarki absolute ku sundon monarku, ndërsa në _____ forma e qeverisjes ishte _____ ku sundon monarku dhe pushteti i tij kufizohet nga _____.

6. Lëvizjet kombëtare të popujve të Evropës gjatë shekujve XVIII-XIX u ndikuan nga Iluminizmi, Revolucioni Francez dhe lindja e kapitalizmit. Në këtë periudhë rizgjohe ndjenjat kombëtare tek popujt që ishin të pushtuar. Dy detyrat që do të zgjidhnin lëvizjet kombëtare në shek. XVIII-XIX janë: **2 pikë**

- a) _____
- b) _____

7. Zhvillimi i tregtisë dhe industrisë solli ndryshime në shoqëritë evropiane. Në këtë periudhë u zhvillua arti dhe lindën koncepte të reja për jetën, shtetin dhe të drejtat. Përcakto se cilës nga lëvizjet i përkasin tiparet e mëposhtme duke vendosur shenjen “+”:

4 pikë


TIPARET	LËVIZJET		
	<i>Nacionalizimi</i>	<i>Romantizmi</i>	<i>Iluminizmi</i>
Mbronin të drejtën që çdo komb duhet të jetë i lirë			
Mbrojnë të drejtën për vetëvendosje			
Mbronin mendimin e lirë dhe barazinë mes njerëzve			
Çmonin dhe nderonin shumë fenë, traditën dhe luftën për lirinë			

8. Gjatë shekujve XVI-XX, popujt e Ballkanit ngrinin krye kundër sundimit osman dhe në sajë të kryengritjeve apo revolucioneve ata arritën të fitojnë autonominë e më pas pavarësinë. Përcakto dallimet mes koncepteve “Shtet autonom” dhe “Shtet i pavarur”.

4 pikë

9. Revolucioni industrial solli zëvendësimin e punës së dorës me makineri. Ky proces filloi afërsisht në vitin 1750 dhe përfundoi në vitin 1850. Revolucioni industrial filloi në Angli. Plotëso skemën duke vendosur një vlerë për çdo degë të ekonomisë.

3 pikë



10. Demokracia angleze në shek. XVII-XVIII nuk ishte gjithëpërfshirëse. Vetëm shtresat e larta gëzonin të drejtën e votës, pjesa tjetër ishin të privuar nga kjo e drejtë. Shkruaj dy nga ndryshimet që solli Akti mbi të Drejtat e Njeriut në shoqërinë angleze. **2 pikë**

a) _____

b) _____

11. Në vitin 1799, Napoleon Bonaparti shpallet Konsull i Parë i Francës. Ai ndërmori reforma të rëndësishme. Në vitin 1804 ai u shpall Perandor i Francës. Përshkruaj figurën e Napoleon Bonapartit duke theksuar sukseset dhe dështimet e tij. **4 pikë**

12. Epoka e restaurimit përfshin vitet 1814-1830. Gjatë kësaj periudhe u rimëkëmb Evropa, si para Revolucionit Francez. Shih hartën dhe përcakto dy nga ndryshimet që solli Kongresi i Vjenës në Hartën e Evropës. **2 pikë**



a) _____

b) _____

13. Perandoria Austriake ishte një shtet shumëkombësh. Nga 37 milionë banorë, vetëm 7 milionë ishin austriakë. Të drejtat dhe liritë që gëzonin nuk ishin të mjaftueshme për popullsinë e

Perandorisë. Evidento dy nga shkaqet e Revolucionit të vitit 1848 në Perandorinë Austriake.

2 pikë

a) _____

b) _____

Skema e vlerësimit

Nota	5	6	7	8	9	10
Pikë	6-11	12-16	17-21	22-25	26 – 29	30 – 31

LËNDA: HISTORI

KLASA: VIII

SHKOLLA: KUSHTRIMI I LIRISË

MËSUES: NAJADA HOXHA

TEST PËR PERIUDHËN E TRETË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematika dhe Koncepte	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Regjimi i kolonelëve	3% 1pikë	Nxënësi: përcakton mënyrën se si u vendos regjimi i kolonelëve;	0	1	0
Shqipëria anëtarësohet në OKB	3% 1pikë	identifikon kohën kur Shqipëria anëtarësohet në OKB;	1	0	0
Ballafaqimet SHBA dhe BS	6% 2pikë	evidenton dy nga ballafaqimet e SHBA me BS në fushën ushtarake;	2	0	0
Perestrojka dhe Gllasnosti	6% 2 pikë	shpjegon dallimet mes Perestrojkës dhe Gllasnostit;	0	2	0
Vendosja e regjimeve komuniste në një pjesë të vendeve të Europës	12% 4 pikë	evidenton 4 nga shtetet e Europës në të cilat u vendosën regjimet komuniste;	4	0	0
Ndryshimet politike në vendet e Ballkanit	12% 4pikë	përcakton kohën kur kanë ndodhur ndryshimet në vendet e Ballkanit;	0	4	0
Sistemi politik në SHBA dhe BS	15% 5pikë	dallon veçoritë mes dy sistemeve;	0	5	0

Lëvizjet shoqërore	6% 2pikë	evidenton dy nga Lëvizjet shoqërore në shek. XX;	2	0	0
Sistemi ekonomik në Europën Perëndimore	6% 2pikë	evidenton dy nga veçoritë e sistemit ekonomik në Europën Perëndimore;	2	0	0
Përdorimi i kompjuterit	9% 3pikë	argumenton rëndësinë e librit dhe përdorimit me kriter të kompjuterit;	0	0	3
Rënia e regjimeve komuniste në Evropë	6% 2pikë	rendit dy nga arsyet e rënies së regjimeve komuniste në Evropë;	2	0	0
Fryma e re në art, kulturë dhe besim	9% 3pikë	interpretion idetë e reja;	0	0	3
Globalizmi dhe efekti “serrë”	6% 2pikë	dallon një nga pasojat e Globalizmit dhe efektit “serrë”;	0	2	0
Pikët total të testit	100% 33 pikë		40% 13 pikë	40% 14 pikë	20% 6 pikë

LËNDA: HISTORI
KLASA: VIII
SHKOLLA: KUSHTRIMI I LIRISË
MËSUES: NAJADA HOXHA
PERIUDHA E TRETË

1. Pas përfundimit të Luftës Civile, jeta politike në Greqi ishte e paqëndrueshme. Në vitin 1967 u vendos regjimi i kolonelëve me: **1 pikë**

A) Revolucion
B) Grusht shteti
C) Zgjedhje
D) Ndërhyrje nga jashtë

2. Anëtarësimi i Shqipërisë në OKB hasi vështirësi. Shteti grek kundërshtonte anëtarësimin e Shqipërisë duke pretenduar për ekzistencën e të ashtëquajturës “gjendje e luftës”. Gjithashtu anëtarësimi pengohej edhe nga Anglia dhe SHBA. Shqipëria bëhet anëtare e OKB-së në:

1 pikë

A) 14 dhjetor 1945
B) 14 dhjetor 1955
C) 14 dhjetor 1965
D) 14 dhjetor 1975

3. Lufta e Ftohtë u mbajt gjallë nga rivaliteti i dy blloqeve ushtarake dhe nga ndarja e Evropës në Perëndim e Lindje. Konfliktet ndërmjet tyre shpesh acaroheshin, por asnjëherë nuk u shndërruan në konflikt të armatosur gjithëpërfshirës. Evidento dy nga ballafaqimet mes SHBA dhe BS në planin ushtarak. **2 pikë**

a) _____
b) _____

4. Shoqëria sovjetike u zhgënjye nga sistemi socialist dhe ideologjia marksiste dhe kërkonte ndryshimin e sistemit. Shpjego dallimet mes reformës “perestrojka” dhe “glasnosti”.

2pikë

Perestrojka_____

Glasnosti_____

5. Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore solli ndryshime në hartën politike të botës. Vështroni hartën dhe shënoni 4 nga shtetet e Europës që pas Luftës së Dytë Botërore u vendosën regjimet komuniste.

4 pikë



1) _____ 2) _____

3) _____ 4) _____

6. Pas vitit 1945 në vendet e Ballkanit u përmbysën monarkitë dhe u zbatua modeli sovjetik në politikë dhe ekonomi. Lidh ngjarjet me kronologjinë e tyre.

4 pikë

Koha	Ngjarjet
A) Në vitin 1947	1. Në Varshavë dhe qytete të tjera të Polonisë, filluan demonstratat e mitingjet masive.
B) Në vitin 1956	2. Në Bullgari komunistët ndaluan me ligj veprimtarinë e partive të tjera.

C) Në vitin 1949	3. Krijohet një aleance që u quajt Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke (KNER).
D) Në vitin 1968	4. Ushtria sovjetike pushtoi Çekosllovakinë.
	5. Studentët çek u ngritën për liri dhe demokraci.

7. SHBA dhe Bashkimi Sovjetik ishin dy nga fitueset e Luftës së Dytë Botërore. Në vitet 1945-1990 sistemet që zbatuan në vendet e tyre ishin të ndryshme. Shëno me “+” veçoritë që i përkasin secilit nga shtetet. **5 pikë**

Veçoritë	Dy sisteme	
	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	Bashkimi Sovjetik
Shtet totalitarist		
Shtet pluralist		
Ekonomi e lirë e tregut		
Ekonomi e centralizuar		
Ekonomi e planifikuar		

8. Në gjysmën e dytë të shekullit XX ndryshon mënyra e jetesës në vendet e Evropës. Ndryshimet erdhën si pasojë e zhvillimit të shkencës dhe teknikës, lëvizjeve demografike etj. Rendit dy nga lëvizjet shoqërore në gjysmën e dytë të shek. XX. **2 pikë**

- a) _____
- b) _____

9. Në vendet e Europës Perëndimore në vitet ‘70 – ‘80 zhvillimi ekonomik pësoi ndryshime. Shkruaj dy nga karakteristikat e ekonomisë në vendet e Evropës Perëndimore në këto vite. **2 pikë**

- a) _____
- b) _____

10. Një nga problemet e sotme është përdorimi pa kriter i internetit. A e zëvendëson përdorimi i kompjuterit librin? Po /Jo. Argumentoni përgjigjen. **3 pikë**

11. Në vitet '80 të shekullit XX vendet e Evropës Lindore përjetonin krizën e sistemit komunist. Rendit dy nga arsytet të cilat sollën rënien e regjimeve komuniste në Evropë. **2 pikë**

a) _____

b) _____

12. Lexo fjalitë e mëposhtme dhe interpretoi ato. **3 pikë**

“Njeriu, nuk është i varur nga asnjë vullnet apo forcë hyjnore apo tokësore që qëndron jashtë tij”. Njeriu e ndërton vetë personalitetin e tij. Ai bën vetë zgjedhjet që dëshiron dhe formon vetveten.

13. Bota e sotme përballët çdo ditë e më shumë me përhapjen e shpejt të politikave, fenomeneve, ngjarjeve por edhe ndotjen e mjedisit. Evidento një nga pasojat e globalizmit dhe të efektit “Serrë”. **2 pikë**

Pasojë e globalizmit

Pasojë e efektit “Serrë”

Skema e vlerësimit

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-7	8-12	13-16	17-20	21-25	26-29	30-33

LËNDA: HISTORI

KLASA: IX

SHKOLLA: KUSHTRIMI I LIRISË

MËSUES: NAJADA HOXHA

TEST PËR PERIUDHËN E PARË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematika dhe Koncepte	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Parahistoria	9% 3pikë	<i>Nxënësi:</i> dallon qendrat parahistorike në vendin tonë;	3		
Origjina e ilirëve	5% 2pikë	përzgjedh tezën që ilirët janë autokton;		2	
Qytetërimi ilir	9% 3pikë	përcakton karakteristikat e qytetërimit ilir;		3	
Shtet ilir	3% 1pikë	përcakton kohën kur lindi shteti i parë ilir;	1		
Sundimi romak	13% 4pikë	përcakton organizimin shoqëror në Iliri pas pushtimit romak;	4		
Ndarja në tema	3% 1pikë	tregon shtrirjen e temës së Selanikut;		1	
Pronë e kushtëzuar dhe e pakushtëzuar	5% 2pikë	bën dallimin mes pronës së kushtëzuar dhe asaj të pakushtëzuar;		2	
Emri alban	3% 1pikë	përcakton kohën kur filloi të përdorej emri alban për arbërit;		1	

Organizimi politik i principatave	9% 3pikë	jep gjykimin e tij për organizimin politik të principatave;			3
Kuvendi i Lezhës	9% 3pikë	përcakton synimin dhe dy nga vendimet e kuvendit të Lezhës;	3		
Gjergj Kastrioti Skënderbeu	9% 3pikë	vlerëson figurën e Skënderbeut;			3
Organizimi shtetëror dhe administrativ	18% 5pikë	dallon veçoritë e organizimit shtetëror dhe organizativ në territoret e pushtuara nga osmanët;	2	3	
Ali Pashë Tepelena	5% 2pikë	përshkruan masat e marra nga Ali Pasha për krijimin e shtetit të pavarur.		2	
Pikët total të testit	100% 33 pikë		40% 13 pikë	40% 14 pikë	20% 6 pikë

LËNDA: HISTORI

KLASA: IX

SHKOLLA: KUSHTRIMI I LIRISË

MËSUES: NAJADA HOXHA

PERIUDHA E PARË

1. Zbulimet arkeologjike tregojnë se gjurmët e para të njeriut në territoret shqiptare i përkasin një periudhe të lashtë, 100 mijë vite më parë. Shiko hartën dhe shëno 3 nga qendrat parahistorike.

3 pikë



- a) _____
b) _____
c) _____

2. Ilirët shtriheshin në Ballkanin Perëndimor. Për origjinën e ilireve janë formuluar dy teza.

Shkruaj tezën që mbështetet në zbulimet arkeologjike dhe studimet gjuhësore.

2 pikë

3. Në shekullin IV-III pr.K., ilirët arritën një shkallë të lartë qytetërimi. Përcakto një nga karakteristikat e qytetërimit ilir për çdo fushë. **3 pikë**

- a) Ekonomia _____
- b) Kultura _____
- c) Organizimi shoqëror _____

4. Në Ilirinë e Jugut u formua Shteti i parë ilir. Evidento kohën kur lindi ky Shtet: **1 pikë**

- A) Shekulli III pr.k
- B) Shekulli IV pr.k
- C) Shekulli V pr.k
- D) Shekulli VI pr.k

5. Sundimi romak solli ndryshime edhe në jetën shoqërore të Ilirisë. Bëj lidhjen e shtresave dhe veçorive të tyre. **4 pikë**

Shtresat	Veçoritë
A) Fshatarët e lirë	1. Aleatë të Romës
B) Administrata romake	2. Zotëronte prona të vogla, të kufizuara
C) Latifondistët	3. Shtresë e pasur që jetonte në qytet
D) Pronarë minierash	4. Gëzonte privilegje të mëdha nga Roma
E) Bujkrobërit	

6. Në shek. IX Perandoria Bizantine bëri një ndarje të re administrative ushtarake, sipas sistemit të temave. Shih hartën dhe përcakto shtrirjen e temës së Selanikut. **1 pikë**



- A) Tivari në veri, gjiri i Vlorës në jug dhe rrjedha e Drinit në lindje
- B) Epiri i Vjetër deri te gjiri i Korintit
- C) Territoret e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore.
- D) Territoret e Maqedonisë Jugore dhe Greqisë Veriore.

7. Vendosija e sistemit feudal përfshiu shekujt X-XIV. Ai lindi me vendosjen e pronës së kushtëzuar dhe përfundoi me lindjen e pronës së pakushtëzuar. Bëj dallimin mes tyre.

2 pikë

8. Emri alban, me të cilin u identifikuan arbrit mesjetarë, i ka fillesat e përdorimit të tij në:

1 pikë

- A) Parahistori
- B) Antikitët
- C) Mesjetë
- D) Rilindje

9. Lexo paragrafin e mëposhtëm dhe jep gjykim tënd për organizimin e principatave shqiptare.

3 pikë

“ ... Unë Gjergj Balsha, vëllai im Balsha dhe nipi im, Gjergji i ri, dhe cilido prej fisit tim, erdha në Dubrovnik dhe ripohova miqësinë e vjetër që kanë pasur të parët e mi me të parët tuaj dhe u betova të ruaj, të mbroj dhe të ndihmoj qytetin tuaj të Dubrovnikut dhe qytetarët tuaj dubrovnikas kudo ku sundoj dhe kudo ku mund ta shtrij sundimin tim. ... ” Balshajt betohen

se do të ruajnë paqen, miqësinë dhe marrëveshjet e vjetra me dubrovnikasit, 17 janar 1368.
Në fund të këtij dokumenti është vula me stemën e Principatës së Balshajve

10. Në fillim të marsit 1444, Skënderbeu thirri një kuvend të fisnikëve arbër dhe princërve fqinjë. Plotëso fjalitë e mëposhtme: **3 pikë**

Lidhja e Lezhës synonte krijimin _____ të fisnikëve shqiptarë dhe fqinjëve të tyre për t'i ballë pushtimit osman. Skënderbeu u zgjodh _____ U krijua një _____.

11. Qëndresa e popujve të ballkanit ndaj sundimit osman ishte e vështirë. Argumentoni tezën “Skënderbeu mbeti figura më e rëndësishme e shpresës për dëbimin e osmanëve nga Ballkani”. **3 pikë**
-

12. Në territoret e pushtuara osmanët emëronin autoritetet lokale, kryenin regjistrimin e të gjitha burimeve ekonomike dhe njerëzore. Përcakto lidhjen mes koncepteve/termave të mëposhtme dhe veçorive të tyre. **5 pikë**

Termet/Konceptet	Veçoritë
A) Sanxhak	1) i dërguari i sulltanit
B) Çiflig	2) ngastër toke, njësia më e vogël taksapaguese
C) Timar	3) taksë me origjinë islame
D) Xhize	4) përbëhej nga disa çifligje
E) Emin	5) njësi administrative-territoriale
F) Disdar	

13. Ali Pashë Tepelena mori masa për krijimin e një shteti të pavarur. Rendit dy prej tyre.

2 pikë

- a) _____
- b) _____

Skema e vlerësimit

Pikët	0-7	8-12	13-17	18-21	22-25	26-29	30-33
Nota	4	5	6	7	8	9	10

LËNDA: HISTORI

KLASA: IX

SHKOLLA: KUSHTRIMI I LIRISË

MËSUES: NAJADA HOXHA

TEST PËR PERIUDHËN E TRETË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematika dhe Koncepte	Përqindja Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Mbledhja e Dytë e Beratit	3% 1 pikë	<i>Nxënësi:</i> dallon vendimin më të rëndësishëm të Mbledhjes së Dytë të Beratit;		1	
Lufta kundër besimeve fetare	3% 1 pikë	identifikon kohën e ashpërsimit të luftës kundër besimeve fetare;	1		
Kosova pjesë e shtetit shqiptar	3% 1 pikë	identifikon periudhën kur Kosova ishte pjesë e shtetit shqiptar;	1		
Vlerësimi i rezistencës së popullit shqiptar	10% 3 pikë	përcakton rezistencën si pjesë të luftës që Aleatët bënë kundër fuqive të Bllokut dhe pjesë të historisë kombëtare;	3		
Ndryshimet në Shqipëri gjatë viteve 1945-2000	18% 6 pikë	bënë lidhjen mes ndryshimeve dhe kohës kur kanë ndodhur;		6	
Lufta e klasave dhe të drejtat e njeriut	13% 4 pikë	shpjegon pasojat që pati lufta e klasave dhe mohimi i të drejtave;			4
Konceptet/ termat	13% 4 pikë	përcakton kuptimin që kanë konceptet inflacion,		4	

inflacion, dekomunistizim, besa kombëtare, tranzicion, rajon autonom		dekomunistizim, besa kombëtare, tranzicion, rajon autonom;			
Deklarata e J.B. Titos	10% 3 pikë	jep gjykimin e tij për deklaratën e J.B.Titos;			3
Arsyet e krizave të tranzicionit	8% 2 pikë	identifikon dy nga arsyet e krizave;	2		
Situata politike në 1997	8% 2 pikë	përcakton 2 elementë që përshkruajnë kaosin e 1997;		2	
Demonstratat e vitit 1981	10% 3 pikë	identifikon pasojat e demonstratave;	3		
Shkaqet e Lëvizjes së dhjetorit 1990	10% 3 pikë	identifikon shkaqet Lëvizjes së Dhjetorit.	3		
Pikët total të testit	100% 33 pikë		40% 13 pikë	40% 13 pikë	20% 7 pikë

LËNDA: HISTORI

KLASA: IX

SHKOLLA: KUSHTRIMI I LIRISË

MËSUES: NAJADA HOXHA

PERIUDHA E TRETË

1. Më 20-23 tetor 1944, në Berat u zhvillua Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Vendimi më i rëndësishëm i mbledhjes ishte: **1 pikë**

- A) Zgjedhja e Këshillit të Përgjithshëm të FNÇ
- B) Zgjedhja e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar
- C) Krijimi i Qeverisë Provizore Demokratike të Shqipërisë
- D) Shpallja e datës së çlirimit të vendit

2. Besimet fetare ishin kundër ideologjisë komuniste. Për këtë arsye regjimi filloi një fushatë të rreptë kundër tyre dhe objekteve të kultit në vitin: **1 pikë**

- A) 1964
- B) 1965
- C) 1966
- D) 1967

3. Në Kosovë pjesa më e madhe e popullsisë janë shqiptarë, por, pjesë e shtetit shqiptar ajo ishte vetëm në periudhën: **1 pikë**

- A) Gjatë Luftës së Parë Botërore
- B) Në periudhën mes dy luftërave botërore
- C) Gjatë Luftës së Dytë Botërore
- D) Pas Luftës së Dytë Botërore

4. Gjatë pesë viteve që vazhdoi pushtimi italian dhe gjerman në Shqipëri, popullit shqiptar iu desh të bënte sakrifica të mëdha. Pati shumë humbje në njerëz dhe pasuri kombëtare. Plotëso fjalitë duke vendosur termat/ konceptet e mëposhtme: **3 pikë**

blloku; historisë botërore; Aleatët e Kombeve të Bashkuara; historisë kombëtare.

Rezistenca dhe lufta e popullit shqiptar kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë është pjesë e rëndësishme e _____. Ajo është pjesë e luftës _____
_____ zhvilluan kundër fuqive të _____.

5. Gjatë viteve 1945-2000 shqiptarët do të përballen me ndryshime në të gjitha fushat e jetës. Vendosni shenjë “+” në vitet kur kanë ndodhur ndryshimet. **6 pikë**

Ndryshimet	Vitet			
	1945- 1948	1948- 1961	1961- 1990	1991- 2000
Sistemi politik ishte ai i partisë-shtet				
Shpallet pluralizmi politik				
Shqipëria ndërpreu marrëdhëniet me Jugosllavisë				
Reforma agrare				
U strukturua dhe u forcua sistemi i burgjeve				
Përfundoi elektrifikimi i vendit				

6. Gjatë regjimit komunist nuk respektoheshin të drejtat dhe liritë e individit. Shpjego pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut gjatë këtij regjimi. **4 pikë**

7. Bëj lidhjen mes koncepteve/ termave dhe kuptimit që ato kanë. **4 pikë**

Konceptet/ termat	Kuptimet
A) Dekomunistizim	1) Situatë ekonomike, kur në treg ka më shumë para se mallra.
B) Inflacion	2) Periudha e kalimit nga një sistem politik në një tjetër të ndryshëm nga i pari.
C) Tranzicion	3) Organizatë e fshehtë për të organizuar qëndresën e shqiptarëve.
D) Besa Kombëtare	4) Proces që synon riorganizimin politik dhe shoqëror të vendit duke iu larguar modelit të vendosur nga regjimi komunist.
E) Rajon autonom	

8. Lexo deklaratën e Josif Broz Titos kur vizitoi Kosovën në vitin 1967 dhe jep gjykimin tënd për të. **3 pikë**


“... Nuk mund të flitet për të drejta të barabarta, kur serbët kanë përparësi kudo nëpër fabrika..., kurse shqiptarët refuzohen dhe pse kanë kualifikime të njëjta apo dhe më të larta...”

9. Në vitin 1997 situata politike në Shqipëri ishte e vështirë. Përcakto dy nga elementët që tregojnë kaosin që kalonte Shqipëria në vitin 1997. **2 pikë**

a) _____

b) _____

10. Gjatë viteve të tranzicionit, shqiptarët janë përballur me kriza. Plotëso skemën duke shënuar dy nga arsyet e këtyre krizave. **2 pikë**



11. Në vitin 1981 shpërthyen demonstratat në Kosovë. Përkthyer pasojat që sollën demonstratat.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

12. Rënia e Murit të Berlinit dhe kriza ekonomike nxiti edhe shqiptarët të shprehnin hapur pakënaqësitë ndaj regjimit komunist. Identifiko 3 nga shkaqet e shpërthimit të lëvizjes së dhjetorit 1990.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

Skema e vlerësimit

Pikët	0-7	8-12	13-17	18-21	22-25	26-29	30-33
Nota	4	5	6	7	8	9	10

ARSIMI I MESEM I LARTË (AML)

LËNDA: HISTORI
KLASA: X
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI

TEST PËR PERIUDHËN E PARË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Temat	Rezultatet e të nxënit	Peshat në %	Pikët	Niveli I	Niveli II	Niveli III
				40%	40%	20%
Qytetërimi antik grek dhe romak	Nxënësi:					
	- shpjegon dhe krahason organizimin politik të qytet – shteteve në Greqinë antike; - shpjegon dhe krahason tiparet e qeverisjes në Greqinë antike; - përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimit antik romak; - identifikon tiparet e organizimit shoqëror në Romën antike;	35	12	5	5	2

Qytetërimet botërore në mesjetë	- shpjegon lindjen e dy autoriteteve në Evropë: Perandori dhe Papa; - argumenton forcimin e autoritetit papal në Evropë; - përshkruan përmbajtjen e Kartës së Madhe të Lirive dhe vlerëson karakterin e saj; - krahason tiparet e parlamentin anglez me atë të asamblesë së përgjithshme në Francë;	38	14	5	5	4
Qytetërimet në fillimet e historisë moderne	- përcakton në hartë rrugën që përshkuan udhëtarët evropianë, në kërkim të Amerikës, Afrikës dhe Australisë; - identifikon rrethanat që shkaktuan “Zbulimet e mëdha gjeografike”; - analizon shkaqet e ndryshimeve fetare në Gjermani;	27	9	4	4	1

	- analizon pasojat e reformës protestante në qytetërimin evropiane.					
Pikët total të testit		100	35	14	14	7

LËNDA: HISTORI
KLASA: X
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI
PERIUDHA E PARË

1. Dy qytet – shtetet më të rëndësishme në Greqinë e lashtë ishin:

1 pikë

- A) Athina dhe Korkyra
- B) Korkyra dhe Aleksandria
- C) Athina dhe Sparta
- D) Aleksandria dhe Sparta

2. Cili numër në hartë tregon vendndodhjen e kryeqendrës së Perandorisë Romake?

1 pikë

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4



3. Si quheshin dy shtresat kryesore të popullsisë në Romën e lashtë?

1 pikë

- A) Plebenj dhe patricë
- B) Patricë dhe skllëvër
- C) Demos dhe plebenj
- D) Demos dhe skllëvër


4. Kryqëzatat u organizuan dhe u drejtuan nga:

1 pikë

- A) Kalifati
- B) Jerusalemi
- C) Kisha Ortodokse
- D) Kisha Katolike

5. Harta e mëposhtme tregon një nga rrugët e zbulimeve të mëdha gjeografike. Rrugën e pasqyruar në hartë e ndoqi: **1 pikë**

- A) Vasko de Gama
- B) Bartolomeo Dias
- C) Kristofor Kolombi
- D) Amerigo Vespuçi



6. Nga qytetërimet më të hershme në Europë, kanë qenë: ai kretas, mikenas dhe etrusk. Nxirrni dy ndryshime midis qytetërimit mikenas dhe atij kretas. **2 pikë**

Ndryshimi i parë:

a) _____

Ndryshimi i dytë:

b) _____

7. Pavarësisht se Sparta dhe Perandoria Osmane u përkasin periudhave kohore të ndryshme nga njëra - tjetra, midis tyre ka disa të përbashkëta në aspektin e organizimit shtetëror. Krahasoni organizimin politik të Spartës me Perandorisë Osmane në fillimet e saj dhe gjeni dy elementë të përbashkët midis tyre. **2 pikë**

a) _____

b) _____

8. Athina ishte djepi i lindjes së demokracisë në antikitet. Përfaqësuesi kryesor i demokracisë në Athinë ishte Perikliu.

a) Nxirrni dy ndryshime midis demokracinë athinase para qeverisjes së Perikliut dhe pas qeverisjes së tij.

2 pikë

Demokracia athinase para Perikliut	Demokracia athinase pas Perikliut

b) Pavarësisht arritjeve të Perikliut lidhur me demokracinë athinase, ajo prapë ishte e kufizuar. Shpjegoni shkurtimisht pse demokracia athinase ishte e kufizuar.

2 pikë

9. Perandoria romake u nda në dy pjesë në vitin 395. Ndarja e saj u shoqërua me ndryshime edhe në aspektin fetar. Bazuar në njohuritë tuaja dhe ato ta marra deri tani, jepni tri nga ndryshimet në drejtim të besimit fetar midis Perandorisë Romake të Lindjes dhe Perandorisë Romake të Perëndimit.

3 pikë

Perandoria Romake e Perëndimit	Perandoria Romake e Lindjes

10. Lëvizja për reformë, u zhvillua gjatë shekullit XVI. Ajo kërkonte reformim thellësisht të Kishës Katolike, e cila ruante pozitën e vet si pronare e madhe toke, por që ishte e mbërthyer nga korrupsioni material e moral.

10.1.Ku lindi për herë të parë reforma protestante? **1 pikë**

- A) Angli
- B) Francë
- C) Gjermani
- D) Itali

10.2.Listoni dy nga shkaqet e lindjes së reformës protestante. **2 pikë**

- a) _____
- b) _____

10.3.Reforma protestante solli ndryshime thelbësore në Evropë. Cilat ishin tri nga ndryshimet që ndodhën në Evropë si pasojë e kësaj reforme' **3 pikë**

- a) _____
- b) _____
- c) _____

11. Shpjegoni dy nga faktorët që ndikuan në rënien e Perandorisë Bizantine. **2 pikë**

- a) _____
- b) _____

12. Cilat ishin tri nga arritjet e Perandorisë së Shenjtë Romake nën drejtimin e Karlit të Madh?

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

13. Argumentoni pse kishte rëndësi të ndërsjellë si për kishën papale ashtu edhe për mbretërit, kurorëzimi i këtyre të fundit nga kisha papale gjatë mesjetës. **3 pikë**

14. Shpjegoni përmbajtjen e Magna Kartës.

3 pikë

15. Krahasoni rolin e Përfaqësisë së Përgjithshme në Francë me atë të Parlamentit në Angli.

2 pikë

Skema e vlerësimit

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 8	9 - 13	14 - 18	19 - 22	23 - 28	29 - 32	33 - 35

LËNDA: HISTORI
KLASA: X
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI

TEST PËR PERIUDHËN E DYTË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematika dhe Tema	Rezultatet e të nxënës	Peshat në %	Pikët	N.2	N. 3	N. 4
				40%	40%	20%
Tematika IV Koha e ndryshimeve thelbësore	<i>Nxënësi:</i>	60%	20	8	7	5
Rusia, perandori e fuqishme	- shpjegon tiparet e qeverisjes së Pjetrit të Madh dhe të Katerinës II; - analizon ndikimin e iluminizmit në zhvillimin e Rusisë;			1		
Spanja dhe Portugalia shtetet e para koloniale	- shpjegon marrëdhëniet midis kolonizatorëve evropiane dhe vendasve; - evidenton pasojat e kolonizimit spanjoll dhe portugez;			2	1	
Anglia në shekullin XVII	- përcakton dhe shpjegon fazat e revolucionit anglez, duke argumentuar					3

	evolucionin politik të tij; - shpjegon tiparet e qeverisjes pas revolucionit në Angli;					
Lufta për pavarësi dhe lufta civile në Amerikën Veriore	- shpjegon shkaqet e luftës për pavarësi të kolonive angleze të Amerikës së Veriut; - analizon kushtetutën amerikane dhe argumenton rëndësinë e saj në demokracinë amerikane;			1		2
Revolucioni Francez i shek. XVIII	- analizon shkaqet e shpërthimit të Revolucionit në Francë; - përcakton dhe shpjegon fazat e Revolucionit Francez;			2	3	
Epoka e Napoleonit dhe epoka e restaurimit	- evidenton ndryshimet politike që pësoi Europa pas rënies së Napoleonit dhe Kongresit të Vjenës;			1		
Revolucioni industrial dhe ndikimi i tij në shoqëri Europiane.	- shpjegon arsyet përse Anglia u bë atdheu i revolucionit të parë industrial;				1	

Bashkimi i Italisë	- shpjegon faktorët e krijimit të shtetit të bashkuar italian; - përcakton në hartë fazat e realizimit të bashkimit të Italisë;				2	
Bashkimi i Gjermanisë.	- analizon rolin e Bismarkut në bashkimin e Gjermanisë;			1		
Tematika V Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)	Rezultatet e të nxënit Nxënësi:	40%	15	6	6	3
Bota pas Luftës së I Botërore	- analizon konceptin e planit të SHBA-së për paqen në botë (14 pikat e Willsonit); - gjykon pasojat politike, ekonomike, sociale dhe psikologjike të Luftës së Parë Botërore dhe të traktateve të paqes në përfundim të saj;			2	2	
Bashkimi Sovjetik	- analizon tiparet e sistemit politik në BRSS;				2	
Fashizmi në Itali	- analizon tiparet e fashizmit në Itali;				1	2
Gjermania	- analizon tiparet e politikës së jashtme			2		1

	dhe të brendshme të nazizmit në Gjermani;					
SHBA modeli i një shteti liberal	- analizon shkaqet dhe tiparet e krizës së viteve 1929 – 1933 në SHBA; - gjykon mbi “Kursin e Ri të Rusveltit si model për të dalë nga kriza ekonomike.			2	1	
Pikët total të testit		100	35	14	13	8

LËNDA: HISTORI
KLASA: X
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI
PERIUDHA E DYTË

1. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë gjatë sundimit të Pjetrit të Madh të Rusisë (1682-1725)? **1 pikë**

A) Eliminimi i Kishës Ortodokse Ruse
B) Humbja e territoreve të Rusisë
C) Çlirimi i fisnikëve nga detyrimet e shumta ndaj shtetit
D) Zëvendësimi i Këshillit të bojarëve me zyrtarë të emëruar

2. Lexoni paragrafët e letrës së Francis Xavier, prift spanjoll jezuit në Indi, drejtuar Ignatius Loyola, kreu i Urdhrit të Jezuitëve, 1549 dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme, duke qarkuar alternativën e saktë.

"Së pari, vendasit e Indisë, për aq sa kam parë, dhe duke folur në përgjithësi, janë barbarë. Është e domosdoshme që ju të keni kujdes të veçantë për të gjithë bijtë e Urdhrit të Jezuitëve në Indi, duke i lavdëruar vazhdimisht Zotit, Zotit tonë, sepse e dini se çfarë është një punë e madhe për njerëzit që, as nuk e njohin Perëndinë, as nuk i binden arsyes. . . .

Unë shoh qartë, nga përvoja ime këtu, se asnjë rrugë nuk po hapet për vazhdimin e rendit jezuit mes vendësve. Krishterimi do të zgjasë mes tyre vetëm për aq kohë sa ne që jemi këtu ose ata që do të dërgoni nga Evropa do të zgjasë dhe do të jetojë. . . .

Portugezët këtu kontrollojnë vetëm bregdetin dhe kështu ata nuk janë të pushtetshëm në brendësi, por vetëm në vendet ku ata jetojnë. Indianët vendas nuk janë aspak të pirur ndaj gjërave të krishterimit, për më tepër i urrejnë ato shumë".

- 2.1. Pikëpamjet e Xavier në paragrafin e dytë, cilin nga konkluzionet e mëposhtme mbështesin në lidhje me periudhën 1450-1648? **1 pikë**

A) Përpjekjet e krishterimit ishin më të suksesshme në Azi sesa në Amerikë

- B) Krishterimi u përdor për të justifikuar tregtinë e skllëvërve afrikanë
- C) Krishterimi përgjithësisht ishte në konflikt me politikat merkantiliste
- D) Krishterimi dhe zgjerimi kolonial evropian ndërvareshin prej njeri-tjetrit

2.2.Mendimet e Xavierit për popullsinë vendase të kolonive si përgjithësim i opinioneve të evropianëve, pasqyronin: **1 pikë**

- A) frikë nga ndikimet e popullsive vendase mbi krishterimin në Evropë.
- B) ndjenjë admirimi të evropianëve për kulturat vendase.
- C) ndjenjë të superioritetit kulturor evropian ndaj kulturave të zbuluara.
- D) ndjenjë faji në lidhje me procesin e kolonizimit.

3. George Warner, *Landmarks in English Industrial History*, Blackie and Son, 1899

“Anglia...ka qenë me fat sepse zotëron kushtet natyrore të domosdoshme për sukses...Ne e dimë që Anglia është e pasur në avantazhe, ajo ka qymyr dhe hekur pranë njeri – tjetrit, delet e saj japin leshin më të mirë, portet e saj janë të shumta dhe që nuk është keq edhe me lumenj, që asnjë pjesë e vendit nuk është më shumë se 70 milje larg nga deti.”

Zhvillimi ekonomik i Britanisë së Madhe mori hov kryesisht pas vitit 1750. Faktorët e mëposhtëm patën ndikim pozitiv në këtë proces, përveç njërit. Identifikojeni atë: **1 pikë**

- A) Anglia kishte një perandori të madhe koloniale
- B) Ekzistenca e një sistemi bankar që ofronte lehtësira kreditimi
- C) Infrastruktura e zhvilluar e transportit të brendshëm
- D) Rritja e numrit të fermerëve të vegjël në fshat si pasojë e gardhimit

4. Qarkoni alternativën e saktë në pyetjet e mëposhtme pasi të lexoni këngën e shitëseve të tregut të Parisit, tetor 1789.

"Drejt Versajës si djem mburravecë,

Ne sollëm me vete të gjitha armët tona

Duhej të tregonim, edhe pse ishim vetëm gra, një guxim që askush nuk mund të na qortojë.

Tani nuk do të duhet të shkojmë aq larg

Kur duam ta shohim mbretin tonë.

Ne e duam atë me një dashuri të pakufishme, pasi ai ka ardhur për të jetuar në kryeqytetin tonë".

4.1.Pjesëmarrësit, në ngjarjet e përshkruara në këngën e mësipërme, nga cili prej faktorëve u motivuan më shumë?

1 pikë

- A) Kriza ekonomike e shkaktuar nga zija e bukës
- B) Dëshira për të krijuar një ekonomi franceze bazuar në parimet e tregut të lirë
- C) Dështimi i Francës për të fituar avantazhe të konsiderueshme nga luftërat e saj me Britaninë
- D) Frika se idetë e Iluminizmit rreth qeverisë do të minonin ekzistencën e monarkisë

4.2.Ngjarjet e përmendura në këngën e mësipërme, çuan fillimisht në cilën prej ndryshimeve të mëposhtme?

1 pikë

- A) Shndërrimi i Francës në një monarki kushtetuese
- B) Krijimi, për herë të parë, i një qeverie republikane në Francë
- C) Vendosja e Napoleon Bonapartit si perandor i francezëve
- D) Rikthimi i lavdishëm i Burbonëve në pushtet

5. "Ngatërresa kufitare", botuar në një gazetë gjermane, 1834.



Karikatura tregon pikat kufitare hyrëse dhe dalëse të Lippe-Schaumberg, një nga shtetet e vogla në Gjermaninë veriperëndimore. Në të thuhet:

"Ju shikoni z. zyrtar kufitar, që unë nuk kam asgjë për të deklaruar, sepse ajo që është në pjesën e prapme të qerres nuk e ka kaluar ende kufirin e Lippe, nuk ka asgjë në mes dhe çfarë është në pjesën e përparme të karrocës tashmë e kaloi kufirin e Lippe. "

Në kohën e botimit të karikaturave, kushtet politike të përmendura më sipër ishin rrjedhojë e cilës prej ngjarjeve të mëposhtme? **1 pikë**

- A) Revolucionit Francez
- B) Bllokada kontinentale kundër Britanisë
- C) Vendimeve të Kongresit të Vjenës
- D) Revolucionit të vitit 1830

6. Cila nga zhvillimet e mëposhtme në historinë gjermane të shekullit të nëntëmbëdhjetë ishte më drejtpërdrejt një përgjigje ndaj shqetësimeve të shprehura në karikaturë? **1 pikë**

- A) Themelimi i legjislacionit të mirëqenies sociale që ofron pensionet e pleqërisë dhe invaliditetit për punëtorë.
- B) Krijimi i Zollverein, një bashkim doganor nën udhëheqjen prusiane, i cili lehtësoi tregtinë dhe nxiti industrializimin.
- C) Mbështetja e qeverisë prusiane për krijimin e një rrjeti të gjerë hekurudhor në shtetet gjermane.
- D) Vazhdimi i praktikave primitive bujqësore dhe modeleve të tokës në disa pjesë të tokave gjermane

7. Ndryshe nga Revolucioni francez, Revolucioni amerikan prodhoi: **1 pikë**

- A) Dhënien e të drejtës së votës grave
- B) Një regjim ushtarak afatshkurtër
- C) Krijimin e aleancave ushtarake strategjike

D) Një kushtetutë të qëndrueshme

8. Parimet e Revolucionit Amerikan dhe të Revolucionit Francez janë të ngjashme në shumë mënyra. Cila nga të pohimet e mëposhtme përmbledh më mirë ngjashmëritë e tyre? **1 pikë**

A) Të dy mbështeteshin mbi ndërtimin e qeverive përfaqësuese
B) Të dy garantonin të drejta votimi të kufizuara për një elitë ekonomike
C) Të dy ruanin privilegje të caktuara trashëgimore për aristokratët
D) Të dy mbështesnin të drejta të barabarta për gratë

9. Sipas disa historianëve, sistemi i aleancave të Europës para vitit 1914, rriti gjasat që: **1 pikë**

A) Një ideal demokratik të përhapet në të gjithë kontinentin
B) Kombet të mbrohen nga shfrytëzimi ekonomik
C) Kolonizimi i kombeve të pazhvilluara të merrte fund
D) Mosmarrëveshjet e vogla të përfundonin në luftëra në shkallë të gjerë

10. 14 pikat e presidentit Uillson do të siguronin një kuadër për të:

1 pikë

A) Ndërtuar një paqe e qëndrueshme dhe e drejtë
B) Përcaktuar dëmshpërblimet e luftës
C) Zgjeruar perandoritë koloniale
D) Ndëshkuar kombet agresore

11. Një objektiv madhor i Francës dhe Britanisë së Madhe në Konferencën e Versajës pas Luftës së Parë Botërore ishte të: **1 pikë**

A) Krijonin një Evropë të bashkuar politikisht
B) Mos lejonin Gjermaninë të rindëronte forcat të saj ushtarake
C) Rivendosnin qeveritë perandorake të paraluftës në pushtet
D) Ndihamoni Gjermaninë të rindërtojë ekonominë e saj industriale

12. Udhëheqësit fashistë në vitet 1920 dhe 1930 fituan mbështetje popullore për shkak të:

1 pikë

- A) Premtimit për të ruajtur paqen me vendet e tjera
- B) Tërheqjes së investimeve të huaja për zhvillimin industrial
- C) Kufizimit të ndikimit ushtarak në qeveri
- D) Thirrjes për nxitjen e krenarisë kombëtare

13. Cili nga vendimet e mëposhtëm i përket Konferencës së Munihut në shtator 1938?

1 pikë

- A) Britania dhe Franca miratuan dorëzimin e krahinës së Sudeteve tek Gjermania
- B) Italia refuzoi të mbështeste Gjermaninë
- C) Gjermanisë ju dha e gjithë Çekosllovakia
- D) Uinston Churchill i bindi të gjitha palët që të bien dakord për një kompromis të arsyeshëm

15. *Në Angli dy goditje të autoritetit të monarkisë u provuan të jenë pika kthese. E para ishte lufta civile dhe ekzekutimi i Karlit I. Por megjithëse kjo ishte një fitore për Parlamentin, periudha kromëelliane që pasoi dhe kthimi nga mërgimi i Karlit II në vitin 1660 hodhën dyshime mbi qëndrueshmërinë e fitores së Parlamentit.*

E dyta ishte "Revolucioni i Lavdishëm" i vitit 1688, i cili e largoi Xhejmsi II nga pushteti pa trazirat e revolucionit të parë dhe konsolidoi supremacinë e Parlamentit në jetën politike angleze.

Argumentoni përse “Revolucioni i Lavdishëm” pati një rol vendimtar në ndryshimin e balancës së pushtetit mes monarkisë dhe parlamentit.

3 pikë

- 16.** Mesi i shek. XIX e gjeti Italinë të copëzuar në shumë shtete të pavarur, si dhe me treva të pushtuara nga fuqitë e huaja. Ndërkohë, në vend popull dhe qarqet patriotike po zinte vend gjithnjë e më shumë vend ideja e bashkimit të tokave italiane në një shtet të vetëm.

Shpjegoni dy rrymat kryesore politiko-ideologjike në gjirin e lëvizjes kombëtare italiane dhe identifikoni disa prej përfaqësuesve më të rëndësishëm të tyre.

2 pikë

- 17.** Shpjegoni dy shkaqe të Luftës Civile në SHBA:

2 pikë

- 18.** Count Brockdorff-Rantzau udhëhoqi delegacionin gjerman në Konferencën e Paqes në Versajë. Më 7 maj 1919, ai protestoi disa terma të traktatit. Këtu është një ekstrakt: *Është kërkuar nga ne që ne do të rrëfejme veten për të qenë vetëm fajtor për luftën. Një rrëfim i tillë nga buzët e mia do të ishte një gënjeshtër. Ne jemi larg nga moslejimi i të gjitha përgjegjësive për faktin se kjo Luftë e Madhe Botërore u zhvillua ose se u zhvillua në një mënyrë të caktuar. . . . Por ne energjikisht e mohojmë se Gjermania dhe njerëzit e saj, të cilët ishin të bindur se luftuan një luftë mbrojtjeje, ishin të vetmit fajtorë. Askush nuk do të donte të pohonte se fatkeqësia filloi vetëm në atë moment shkatërrues kur pasardhësi i Austro-Hungarisë ra viktimë e duarve vrastare. Gjatë pesëdhjetë viteve të fundit, imperializmi i të gjitha shteteve evropiane ka helmuar vazhdimisht marrëdhëniet ndërkombëtare. Politikat e hakmarrjes, politikat e zgjerimit dhe mosrespektimi i të drejtës së popujve për të përcaktuar fatin e tyre kanë kontribuar në sëmundjen evropiane, e cila erdhi në një krizë të Luftës së Parë Botërore. Mobilizimi i Ruisë i privonte shtetasit nga mundësia e shërimit të sëmundjes dhe e vendosi çështjen në duart e fuqive ushtarake.*

- a) Cila ishte pozita e tij në bisedime si udhëheqësi i delegacionit gjerman?

1 pikë

b) Çfarë e shkaktoi luftën sipas tij? Po ti, çfarë mendon se e shkaktoi atë vërtetë? **2 pikë**

Në opinionin e drejtuesit të delegacionit gjerman:

19. *"Babai im dilte çdo ditë në rrugë për të kërkuar punë... Nëna ime shkonte për të punuar, edhe unë punoja duke luajtur piano për klasa vallëzimi të shtunën në mëngjes për pesëdhjetë cent në orë. Nëna ime do të gjente pak pense dhe ne do të shkonim tek shitësi i ushqimore dhe do të prisnim derisa të hidhnin gjëra që ishin duke filluar të kalbeshin. Ne do të zgjedhim patatën më pak të kalbur dhe zarzavate dhe karotat që ishin tashmë të buta. Pastaj do të shkonim tek kasapi dhe do ta lusim për një kockë. ..Dhe pastaj me pak pense ne do të blinim një kuti me elb për të bërë një supë për të kaluar tre apo katër ditë. Dhe mos harroni se nëna do të më thoshte ndonjëherë, 'Ju dilni dhe bëjeni atë. Mua më vjen turp.'"*

Clara Hancox, cituar në gazetën "Shekulli", nga Peter Jennings dhe Todd Breëster

a) Si ka ndikuar Depresioni i Madh tek Klara dhe familja e saj? **1 pikë**

b) Identifikoni dy nga masat e programit Neë Deal-it të propozuar nga presidenti Ruzvelt për kapërcimin e krizës ekonomike botërore 1929 – 1933? **2 pikë**

20. *"Një gjak kërkon një Rajh. Kombi gjerman nuk do të ketë kurrë të drejtë morale të hyjë në politikat koloniale derisa, të paktën, të përfshijë bijtë e tij në një shtet të vetëm...Tokat e shtypura do të kthehen në gjirin e Rajhut të përbashkët, jo nëpërmjet protestave të flakta, por me anë të shpatës së fuqishme."*

Adolf Hitler 1925

a) Çfarë i duhej Gjermanisë sipas Hitlerit?

1 pikë

b) Si do të çonte kjo rrugë Gjermaninë drejt luftës?

1 pikë

21. *Idetë totalitare kanë pasur një ndikim të madh në jetën e njerëzve dhe kombeve të ndryshme sidomos gjatë shek. XX. Shpeshherë regjimet totalitare të majta dhe të djathta kanë qenë në konflikt të egër me njeri-tjetrin. Por a janë ata kaq të ndryshëm mes tyre?*

Identifikoni dy tipare të veçanta të regjimeve totalitare të majta dhe të djathta: **2 pikë**

Regjime totalitare të majta	Regjime totalitare të djathta

22. *“Nëse ky vend (Franca) nuk do të jetë më monarki kjo do të jetë plotësisht faji i Luigjit XVI. Një gabim trashanik pas një tjetri...kanë qenë shkatërrimi mbretërisë së tij.”*

Lord Gover, ambasadori britanik në Francë

Shpjegoni tri arsye përse Luigji XVI u ekzekutua nga revolucionarët, duke u mbështetur në aspektet shoqërore në Francë para revolucionit, natyrën e sundimit të Luigjit XVI dhe ndikimin e tij mbi Francën.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

Skema e vlerësimit

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 8	9 - 13	14 - 18	19 - 22	23 - 28	29 - 32	33 - 35

LËNDA: HISTORI
KLASA: XI
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI

TEST PËR PERIUDHËN E PARË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Temat	Rezultatet e të nxënit	Peshat në %	Pikët	Niveli I	Niveli II	Niveli III
				40%	40%	20%
Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare	Nxënësi: - identifikon ekzistencën e kulturave parahistorike; - gjykon rolin që luajtën kolonitë greke në shkëmbimin kulturor ndërmjet dy qytetërimeve; - vlerëson kontributin e mbretërive ilire dhe drejtuesve të tyre në zhvillimin e qytetërimit ilir; - gjykon mbi ndryshimet që pësoi jeta dhe kultura ilire gjatë sundimit romak;	39	13	5	6	2

Territoret shqiptare në mesjetë	- gjykon për pasojat e dyndjeve sllave në Ballkan dhe territoret shqiptare; - përshkruan tiparet kryesore të organizimit politik e shoqëror të Principatës së Arbrit;	28	9	4	4	1
Shqiptarët në fund të shek. XIV – fillimin e shek. XX	- analizon vendimet e Kuvendit të Lezhës duke vlerësuar rëndësinë e tyre; - analizon tiparet e shtetit nën drejtimin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.	33	12	5	4	3
Pikët totale		100	34	14	14	6

LËNDA: HISTORI
KLASA: XI
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAJ
PERIUDHA E PARË

1. Në cilën nga periudhat e mëposhtme nisi formimi i vetëdijes së përbashkët kulturore dhe etnike (etnogjeneza) të fiseve ilire? **1 pikë**

- A) Neolit
- B) Eneolit
- C) Bronz
- D) Hekur

2. Cili prej fiseve të mëposhtme e mori pas enkelejdëve stafetën në krijimin e shtetit ilir? **1 pikë**

- A) Molosët
- B) Dardanët
- C) Taulantët
- D) Ardianët

3. Në Arbërinë bizantine, pronë tokësore shtetërore e kushtëzuar me detyrim ushtarak dhënë një feudali është: **1 pikë**

- A) Pronja
- B) Bashtina
- C) Stratiotika
- D) Pronë e institucioneve fetare

4. Cila prej principatave të mëposhtme konsiderohet si vazhduese e drejtpërdrejtë e Principatës Arbërore mesjetare: **1 pikë**

- A) Topiajt
- B) Balshajt
- C) Muzakajt
- D) Zenebishtajt

5. Cili prej sundimtarëve të Pashallëkut të Shkodrës (Bushatllinjve) arriti të krijonte Konfederatën Ilirike?

1 pikë

- A) Mehmet pasha
- B) Mahmut pasha
- C) Ibrahim Pasha
- D) Mustafa pasha

6.

a) Cili ishte qëllimi i formimit të kolonive greke në Iliri?

1 pikë

b) Përmendni një prej kolonive greke më të njohura në bregdetin e Ilirisë.

1 pikë

c) Çfarë përfitoi Iliria nga ngritja e këtyre kolonive? Renditni dy prej tyre.

2 pikë

a) _____

b) _____

7. “...Pastaj Pretori arriti në Skodra, e cila ishte pika më me rëndësi e luftës, sepse Genti e kish zgjedhur këtë si fortesë të gjithë mbretërisë, duke qenë vendi më i fortë i labeatëve dhe i vështirë për t’u afruar.

... por ata dolën nga porta dhe, në fushë të hapur nisën luftën me romakët, duke treguar më shumë guxim sesa qëndresë”.

“Libri XLIV”, Tit Livi

a) Për cilin konflikt të ilirëve bën fjalë pasazhi i mësipërm? **1 pikë**

b) Jepni një nga arsyet e lindjes së këtij konflikti? **1 pikë**

c) Cilat ishin dy nga shkaqet e dështimit të ilirëve në këtë konflikt? **2 pikë**

a) _____

b) _____

d) Cili ishte fati i Ilirisë pas këtij dështimi dhe jepni dy nga pasojat që pati Iliria pas këtij dështimi. **3 pikë**

Fati i Ilirisë:

Pasojat:

a) _____

b) _____

8. Dyndjet sllave në gadishullin e Ballkanit patën pasoja të rënda për popullsitë autoktone të kësaj treve. Megjithatë, një pjesë e rëndësishme e popullsisë ilire ruajti të paprekur karakterin e vet etnik dhe kompaktësinë përballë këtij rreziku. Listoni tri arsye pse në Ilirinë e Jugut popullsia ilire i rezistoi asimilimit sllav: **3 pikë**

a) _____

b) _____

c) _____

9.

a) Cili ishte formacioni i parë shtetëror shqiptar i mirë organizuar gjatë periudhës mesjetare?

1 pikë

b) Jepni tri argumente për të mbështetur përgjigjen tuaj.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

Për t'ju përgjigjur pyetjeve nga 10–13 referojuni pasazhit të mëposhtëm

Kuvendi i Lezhës është skalitur në historinë e popullit shqiptar si një ngjarje kulmore me ndikim shumë të madh në organizimin e rezistencës ndaj pushtuesve osmanë. Çlirimi i vendit me kryengritjen e përgjithshme të vitit 1443, ishte një fitore historike që duhej mbrojtur e çuar më tej nëpërmjet bashkimit të forcave të brendshme politike, ushtarake dhe ekonomike, si dhe bashkëpunimit me vendet e tjera. Një kuvend me një përfaqësi kaq të gjerë kombëtare, që u vendos të mbahej në Lezhë nga shqiptarët, është i pari që njihet deri atëherë në historinë e tyre. Ky kuvend realizoi të parin bashkim të gjerë politik e ushtarak të vendit në formën e një aleance ndërmjet përfaqësuesve kryesorë të aristokracisë shqiptare. Megjithatë, me kalimin e viteve u bë gjithnjë e më e domosdoshme të kapërceheshin sa më parë dobësitë e brendshme, të cilat pengonin zhvillimin me sukses të luftës. Përsheptimin e procesit të bashkimit politik të shqiptarëve e favorizonte shumë autoriteti i madh gjithnjë në rritje që Skënderbeu kishte te bashkëkombësit e vet, tek i cili këta shihnin drejtuesin e aftë dhe komandantin e talentuar, që vazhdimisht po u sillte fitore.

10. Jepni një argument pse u zgjodh Lezha si vend i mbajtjes së Kuvendit.

1 pikë

- a) _____

11. Argumentoni tri nga avantazhet e shtetit të Skënderbeut në raport me Lidhjen e Lezhës.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

12. Identifikoni dy nga vendimet e Kuvendit të Lezhës.

2 pikë

- a) _____
b) _____

13. Cilat ishin dy prej rrugëve që u përdorën nga Skënderbeu për të kaluar nga Lidhja e Lezhës si aleancë politike në një shtet të përqendruar në duart e tij?

2 pikë

- a) _____
b) _____

14. Pashallëqet e mëdha shqiptare ishin formacione të cilat shfaqën tipare të rëndësishme shtetërore. Krahasoni pashallëkun e Janinës me atë të Shkodrës në drejtim të organizimit dhe mënyrës së funksionimit të tyre duke nxjerrë tri ndryshime midis këtyre dy pashallëqeve.

3 pikë

- a) _____
b) _____
c) _____

Skema e vlerësimit

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 8	9 - 13	14 - 18	19 - 22	23 - 27	28 - 31	32 - 34

LËNDA: HISTORI
KLASA: XI
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI

TEST PËR PERIUDHËN E TRETË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Temat	Rezultatet e të nxënit	Peshat në %	Pikët	Niveli I	Niveli II	Niveli III
				40%	40%	20%
Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)	Nxënësi:					
	- shpjegon vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri; - analizon tiparet kryesore të këtij regjimi; gjykojnë pasojat që solli për Shqipërinë dhe shqiptarët regjimi komunist, gjatë viteve 1944-1990; - përshkruan gjendjen ekonomike, politike dhe aspekte të jetës së përditshme të shqiptarëve të Kosovës në vitet 1945-1990;	67	21	9	8	4
Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë	- gjykon mbi periudhën e rënies së regjimit komunist në Shqipëri dhe fitores së demokracisë; - vlerëson përpjekjet e Shqipërisë për integrim në strukturat euro-atlantike, si	33	9	3	4	2

	dhe sfidat e shoqërisë shqiptare në ditët e sotme; - vlerëson rëndësinë që pati për Kosovën, Shpallja e Pavarësisë.					
Totali		100	30	12	12	6

LËNDA: HISTORI
KLASA: XI
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI
PERIUDHA E TRETË

Për t'ju përgjigjur pyetjeve nga 1–4 referojuni dokumentit të mëposhtëm.

Ti ke ra këmb e krye në pozitat e Ballit me këtë trakt, ku flitet për Shqipni etnike dhe ku nuk flitet aspak për luftën kundra fashizmit dhe për luftën tonë. Asnjë fjalë nuk ka në trakt për Partinë Komuniste. Bashkimin e keni bërë me kondita paritetike në mes të Ballit që është një organizatë dhe Këshillit Nac.Çli. që është një front. Me këtë trakt juve pranoni që të hidhet një perde në tërë të kaluemen dhe të tashmen e fëlliqun të Ballit dhe i hapni dyert Ballit që të hyjë triumfalisht në histori. Prandaj ky trakt i cili shkel kryekëput vijën tonë politike, dënohet nga Komiteti Qendror.... Duhet të kuptosh që Balli si edhe të gjithë oportunistët e tjerë kanë sot nevojë të madhe për të kapërcyer me marifet të kalumen; duhet të kuptosh se ata janë vërsul me tërë forcat e tyre për të trashëguar fashizmin që po vdes; për të marrë pushtetin dhe për të na larguar neve nga radha e parë ku jemi sot dhe për të na dhanë shqelmin nesër; veçanërisht kur konditat politike të jashtme po rukullisen juve nuk deklaroni luftën kundra fashizmit por proklamoni independencën kur okupatori është edhe brenda, gjithashtu dhe Shqipnin Ethnike, thezë që mbron vetëm fashizmi dhe reaksioni.

...Emëri i Këshillit për Shpëtimin e Shqipërisë është krejt i gabuar si në fond edhe në formë...

Pjesë nga letra e Enver Hoxhës dërguar Ymer Dishnicës në 9 gusht 1943

1. Identifikoni ngjarjen historike së cilës i referohet Enver Hoxha në letrën e tij:

1 pikë

- A) Mbledhja e Beratit
- B) Konferenca e Pezës
- C) Konferenca e Mukjes
- D) Konferenca e Labinotit

2. Listoni dy nga vendimet e marra me miratimin e përfaqësuesve të dy palëve në këtë takim:

2 pikë

a) _____

b) _____

3. Bazuar në dokumentin e mësipërm, identifikoni qëndrimin që mbajti PKSH ndaj vendimeve që u morën në këtë konferencë.

1 pikë

4. Jepni dy argumente pse PKSH mbajti atë qëndrim.

2 pikë

a) _____

b) _____

Për t'ju përgjigjur pyetjeve nga 5–8 referojuni dokumenteve të mëposhtme.

Dokumenti nr. 1

“Përmbajtja e traktatit është që të dy vendet të koordinojnë planet e tyre ekonomike në baza të përbashkëta dhe për këtë arsye do të ngrihen organe koordinimi. Njësia e vlerës së monedhës do të jetë e barabartë për të dy vendet, prandaj Republika shqiptare duhet të shpjerë vlerën e njësisë së monedhës baras me dinarin. Qeveria e R. F. P. të Jugosllavisë angazhohet në këtë traktat të furnizojë Shqipërinë me plaçkë tregu dhe material të caktuar në marrëveshje, që parashikohet sipas koordinimit të planeve për të mbajtur vlerën e lekut baras me dinarin. Të dy qeveritë angazhohen që brenda një muaji të zhduken kufijtë doganorë dhe doganat në mes të dy vendeve, duke krijuar një territor doganor mik, në krye të secilit do të ketë një komision shqiptaro-jugosllav.”

(Nga “Traktati mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe barazimin e monedhave midis R. P. të Shqipërisë dhe R. F. P. të Jugosllavisë”, nënshkruar në Beograd më 27 nëntor 1946.)

Dokumenti nr. 2

“Ushtria shqiptare duhej të kishte një plan unik operacional në rast lufte me ushtrinë jugosllave; të gjitha urdhëresat e ushtrisë jugosllave do të ishin të vlefshme edhe për ushtrinë shqiptare;

legjislacioni po ashtu; ushtria shqiptare të përfshihej në buxhetin e ushtrisë jugosllave. Pranë Ministrisë së Mbrojtjes Popullore të Shqipërisë të vinte një delegat i Ministrisë së Mbrojtjes Popullore Jugosllave; në ushtrinë shqiptare nuk kishte më nevojë që të vinin instruktorët sovjetikë ushtarakë që ishin paralajmëruar...”

(Nga propozimi i delegacionit ushtarak jugosllav ardhur në nëntor 1947 "Platforma e unifikimit të ushtrisë shqiptare me atë jugosllave në vitin 1947", Prof. Dr. Ana Lalaj)

5. Duke u mbështetur në paragrafët mbi “Traktatin ekonomik”, shpjegoni natyrën e marrëdhënieve ekonomike shqiptaro – jugosllave në vitet 1945 - 1948. **2 pikë**
-

6. Jepni dy argumente nëse këto marrëveshje ishin apo jo në favor të ekonomisë shqiptare.

2 pikë

- a) _____
- b) _____

7. Nisur nga propozimet e delegacionit ushtarak jugosllav, identifikoni një nga synimet politike të udhëheqjes jugosllave ndaj Shqipërisë në vitet 1945 – 1948. **1 pikë**
-

8. Identifikoni një nga faktorët e jashtëm që ndikoi në prishjen e marrëdhënieve mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë në vitin 1948. **1 pikë**
-

9. *Data 29 nëntor 1944 shënoi jo vetëm çlirimin e Shqipërisë nga pushtimi nazi-fashist, por edhe fillimin e një periudhe transformimesh rrënjësore politike, ekonomike e shoqërore. Në vend u vendos një regjim i ri, i panjohur më parë për popullin shqiptar. Kjo gjë pati pasoja të mëdha në gjirin e shoqërisë shqiptare, të cilat ndihen edhe sot.*

Shteti shqiptar i dalë nga lufta ishte shumë i dobët dhe me burime të pakta financiare. Identifikoni dy prej rrugëve më të përdorura për tejkalimin e këtij problem. **2 pikë**

- a) _____
- b) _____

10. Shqipëria dha kontributin e saj në fitoren e koalicionit të vendeve antifashiste duke u rreshtuar qartazi në krahun fitimtar. Megjithatë, dyert e OKB për Shqipërinë u hapën vetëm pas 10 vitesh nga themelimi i kësaj organizate. Jepni tri nga arsyet e qëndrimit të OKB ndaj Shqipërisë.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

11. Në Kongresin XX të PKBS, udhëheqësi sovjetik Hrushovi, denoncoi “krimet e Stalinit” dhe “kultin e individit” dhe bëri thirrje për të ndryshuar mënyrën e drejtimit të vendeve të Bllokut Komunist drejt një liberalizimi dhe hapje më të madhe. Nga ana e tij, udhëheqësi komunist shqiptar Enver Hoxha ishte ndër të paktët drejtues të Bllokut që, ndonëse formalisht e pranoi atë, praktikisht nuk u pajtua me frymën e Kongresit të XX.

Cilat ishin dy arsyet që E. Hoxha mbajti këtë qëndrim?

2 pikë

- a) _____
- b) _____

12. Pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e Bllokut Komunist, Shqipëria vendosi marrëdhënie të ngushta, sidomos ekonomike, me Kinën komuniste duke marrë prej saj ndihma të konsiderueshme materiale. Shqipëria dhe Kina ishin dy vende të ndryshme në shumë pikëpamje dhe ndodheshin edhe gjeografikisht shumë larg nga njëri tjetri. Është evident interesi i Shqipërisë për këto marrëdhënie.

Jepni një argument, pse Kina shfaqti interes për këtë vend të vogël e të largët, siç ishte Shqipëria.

1 pikë

13. Historiku i Kosovës nën Jugosllavinë federative është i mbushur me ngjarje të rëndësishme për popullsinë shqiptare që jetonte brenda kufijve të shtetit jugosllav.

a) Cili ishte statusi që mori Kosova në bazë të kushtetutës së vitit 1946, si pjesë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë:

1 pikë

b) Refuzimi i cilës marrëveshje nga ana e Serbisë i hapi rrugën angazhimit ushtarak të NATO-s për zgjidhjen e konfliktit në Kosovë?

1 pikë

c) Në cilin vit u kurorëzuan përpjekjet e popullsisë shqiptare të Kosovës për pavarësi?

1 pikë

14. Identifikoni një nga ndryshimet që propozoi dhe ndërmori Ramiz Alia në prag të shembjes së Murit të Berlinit.

1 pikë

15. Cilat ishin dy qytetet në Shqipëri ku u organizuan për herë të parë protestat ndaj regjimit komunist?

1 pikë

A) Tirana dhe Shkodra

B) Tirana dhe Kavaja

C) Shkodra dhe Kavaja

D) Kavaja dhe Durrësi

16. Cila ngjarje është shënuar në 1 prill të vitit 2009 për Shqipërinë?

1 pikë

- A) Anëtarësimi në programin e Partneritetit për Paqe
- B) Dhënia e vendit të statusit kandidat për në BE
- C) Anëtarësimi në NATO
- D) Liberalizimi i vizave

17. Shqipëria është tashmë një nga vendet e Ballkanit Perëndimor që përpiqet të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian. Prej rrëzimit të diktaturës komuniste e deri më sot, ky proces ka pasur lëkundjet e veta, sikundër ka pasur edhe arritje. Në këndvështrimin tuaj, bazuar në argumente, analizoni faktorët që ndikojnë në çeljen e bisedimeve për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

4 pikë

Skema e vlerësimit

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 8	9 - 13	14 - 17	18 - 21	22 - 24	25 - 27	28 - 30

LËNDA: HISTORI
KLASA: XII
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI

TEST PËR PERIUDHËN E DYTË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematika dhe Tema	Rezultatet e të nxënit	Peshat në %	Pikët	N.2 40%	N. 3 40%	N. 4 20%
TEMATIKA 4 Historia moderne (shek. XV – fillim shekulli XX	<i>Nxënësi:</i>	60%	21	8	7	6
Islamizimi i shqiptarëve	- tregon procesin e përhapjes së fesë islame tek shqiptarët; - identifikon rrugët e përhapjes së islamizimit; - analizon shkaqet e islamizimit të popullsisë shqiptare;			1		
Lindja e shkencës moderne dhe filozofisë iluministe në Europën Perëndimore (shek. XVII–XVIII)	- shpjegon përhapjen e mendimit kritik kundrejt dijeve tradicionale dhe ndikimit të fesë mbi shkencën, duke vënë në dukje rëndësinë që nisën të marrin idetë mbi të drejtat natyrore të njeriut në zhvillimin e botës moderne;			1		

	- shpjegon përmbajtjen e ideve kryesore iluministe dhe evidenton rrymat kryesore të mendimit iluminist; - identifikon figurat kryesore të iluminizmit me theks të veçantë të filozofet franceze;					
Revolucioni Francez dhe krijimi i modelit të shtetit komb	- shpjegon raportin e ri të vendosur mes shtetit dhe kishës dhe karakterin laik të shtetit francez pas revolucionit; - analizon konceptin e shtetit-komb dhe faktorët historik që çuan në formimin e shteteve-kombe në Europë;			2	2	
Kongresi i Vjenës dhe restaurimi i Europës pas Napoleonit	- argumenton karakterin restaurues të vendimeve të Kongresit të Vjenës;			1		
Ngritja e Rusisë dhe fillimet e Çështjes Lindore (shek. XVIII–fillim shek. XIX)	- vë në dukje centralitetin e idesë së ortodoksizmit në përpjekjet për shkëputje të popujve ballkanikë dhe shpërbërjen e Perandorisë Osmane në Ballkan;			1		
Rusia dhe kryengritja serbe (Pansllavizmi). Rusia dhe Kryengritja	- shpjegon konceptin e pansllavizmit dhe				1	

Greke (Aleanca ortodokse)	analizon idetë kryesore të tij;					
Reagimi shqiptar: Lidhja e Prizrenit	- analizon zhvillimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ballafaqimin e qëndrimeve të drejtuesve të saj dhe rëndësinë e kësaj ngjarjeje;					3
Perandoria Osmane mes Rusisë dhe Austro-Hungarisë (fillim shek. XX)	- evidenton arsyet përse Ballkani ishte vend i përplasjeve mes interesave të Fuqive të Mëdha dhe Perandorisë Osmane; - argumenton synimet e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve ballkanike për rregullimin gjeopolitik të Ballkanit pasosman;			1	3	3
Luftërat ballkanike dhe Pavarësia e Shqipërisë	- shpjegon raportet dhe ekuilibrat mes shteteve ballkanike dhe Perandorisë Osmane në fillim të shekullit XX.			1	1	
TEMATIKA 5 Periudha bashkëkohore (1919 deri më sot)	Nxënësi:	40%	14	6	6	2

Paqja e Versajës dhe krijimi i rendit të ri botëror	- evidenton parimet themelore të pranuar nga Konferenca e Versajës për ravigjëzimin e hartës së re politike;			2		
Aspekte të konsolidimit dhe modernizimit të shtetit shqiptar (1920–1939)	- dallon elementë të ndërtimit dhe konsolidimit të shtetit kombëtar në Shqipërinë e viteve 1920-1939;			1		
Jugosllavia në vitet 1918 –1939	- evidenton momentet kryesore në krijimin e shtetit jugosllav si shtet shumë etnik; - shpjegon konfliktet e brendshme mes etnive të shtetit jugosllav;			1	2	
Kriza ekonomike botërore dhe rrjedhojat në Ballkan	- analizon ndikimet që kriza ekonomike botërore pati në ekonominë dhe në politikën shqiptare dhe ballkanike;				1	2
Fuqitë e mëdha dhe bashkëpunimi ballkanik: Konferencat e viteve '30	- analizon paktin Kellog-Briand, duke evidentuar ndikimin që ai pati në bashkëpunimin ballkanik; - përshkruan disa nga vendimet e konferencave ballkanike të viteve '30;			1		

Ideologjitë totalitare dhe Ballkani	- përshkruan gjendjen politike të Ballkanit në vitet '20-30;			1		
Përpyjekjet për shmangien e pushtimit dhe shkaqet e pushtimit italian të Shqipërisë	- evidenton ecurinë e marrëdhënieve shqiptaro-italiane në prag të pushtimit të Shqipërisë; - shpjegon tentativat e A. Zogut në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar për të evituar pushtimin italian.				3	
Pikët total të testit			35	14	13	8

LËNDA: HISTORI
KLASA: XII
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI
PERIUDHA E DYTË

1. Evidentoni rrugën që zgjodhi pjesa kryesore e fisnikërisë shqiptare në raport me Perandorinë Osmane: **1 pikë**

- A) Braktisi pronat e veta dhe emigroi në Perëndim
- B) Vazhdoi rezistencën antiosmane
- C) Përqafoi fenë islame dhe u integrua në strukturat shtetërore osmane
- D) Ruajti unitetin me popullin përballë presionit osman

2. *“... të gjithë njerëzit janë nga natyra në mënyrë të barabartë të lirë dhe të pavarur, dhe kanë të drejta të caktuara të qenësishme, të cilat kur hyjnë në një gjendje shoqërie, ata nuk mund të heqin ose asgjësojnë pasardhësit e tyre me asnjë kompakt; domethënë gëzimin e jetës dhe të lirisë, me mjetet e fitimit dhe zotërimit të pronës, dhe ndjekjes dhe marrjes së lumturisë dhe sigurisë.”*

Deklarata e të Drejtave, 1776 e Virxhinias

Idetë e cilit filozof ishin bazë për këtë citat nga Deklarata e të Drejtave e Virxhinias? **1 pikë**

- A) Charles-Louis Montesquieu
- B) Jean-Jacques Rousseau
- C) John Lok
- D) Voltaire

3. Cila prej alternativave të poshtëshënuara, ishte pjesë e planit të Katerinës II mbi të ashtuquajturin “Projekti Grek”? **1 pikë**

- A) Rusia do të shkëmbente territore me Perandorinë Osmane në Kaukaz

- B) Edukimi në Rusi i nëpunësve që do të kishin pozita të larta në shtetin e ardhshëm grek
- C) Organizimi i një konference mes Fuqive të Mëdha
- D) Aleancë me shqiptarët për të tërhequr vëmendjen e Perandorisë Osmane

4. Kongresi i Vjenës arriti një marrëveshje mes Fuqive të Mëdha europiane (e njohur edhe si “Koncerti i Evropës”). Në këtë kuadër, ndërmjet 1815 dhe 1848, këto fuqi e shtypën nacionalizmin duke:

1 pikë

- A) Siguruar një ekuilibër të forcës midis shteteve
- B) Nxitur institucionet demokratike
- C) Ndarë kolonitë midis Fuqive të Mëdha
- D) Vendosur lidhje ekonomike ndërkombëtare

5. Identifiko, pritshmërinë e shqiptarëve prej zhvillimeve që sillte Revolucioni Xhonturk?

1 pikë

- A) Identifikimin e kombit me fenë
- B) Njohjen dhe vetëqeverisjen e kombit shqiptar
- C) Reforma centralizuese osmane
- D) Kryerjen e një reforme agrare

6. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë lidhur me diskutimet për kufijtë e shtetit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në 1913?

1 pikë

- A) Qyteti i Gjakovës kaloi nën sovranitetin e Malit të Zi
- B) E ardhmja e qytetit të Gjirokastrës u përcaktua që në fillim
- C) Franca dhe Rusia përkrahën pa rezerva pretendimet e shtetit shqiptar
- D) Qendër e mosmarrëveshjeve mes dy blloqeve ishte çështja e Shkodrës

7. Identifiko tiparin kushtetues që ishte i pranishëm si në Statutin Organik të Vidit, ashtu edhe në Statutin Organik të Lushnjës:

1 pikë

- A) Parlamenti ishte institucioni shtetëror me kompetencat më të gjera
- B) Zgjedhja e parlamentit me votim të drejtpërdrejtë nga populli
- C) Përcaktimi i formës monarkike të qeverisjes së vendit
- D) Roli dominues i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit

8. Identifiko arsyen pse vetëm disa prej 14 pikave të Uillsonit u përfshinë në Traktatin e Paqes në Paris: **1 pikë**

- A) Kishte këndvështrime të ndryshme mes fuqive aleate fituese
- B) SHBA ishin shumë të preokupuara me imperializmin aziatik
- C) Vendet e tjera evropiane ishin më të prekura nga lufta se SHBA
- D) Rritja e lëvizjes feministe në Evropë mori me shumë vëmendje në konferencë

9. Cila ide bazë u pranua si nga Britania, ashtu edhe Franca në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919? **1 pikë**

- A) Itali duhej të hiqte dorë nga kolonitë e saj në Afrikë
- B) Gjermania duhej të ndahej në zona pushtimi
- C) Fuqia ushtarake gjermane duhej të kufizohej ndjeshëm
- D) Fuqitë e Bllokut Qendror duhej të paguanin dëmshpërblime për luftën në mënyrë të barabartë

10. Evidento një prej vështirësive në krijimin e një administrate shtetërore funksionale pas njohjes përfundimtare të pavarësisë së Shqipërisë: **1 pikë**

- A) Ndërhyrja e vazhdueshme e Perandorisë Osmane
- B) Karakteri laik që mori shteti shqiptar
- C) Mungesa e nëpunësve shtetërorë të përgatitur
- D) Krijimi i një sistemi arsimor kombëtar

11. *“Legjioni i Archangel Michael (Garda e Hekurt) ishte sigurisht lëvizja masive më e pazakontë e Evropës ndërluftuese. Në përgjithësi klasifikohet si fashiste sepse plotësonte kriteret kryesore të çdo tipologjie të përshtatshme fashiste, por paraqiti karakteristika të pamohueshme individuale të vetvetes. Jo vetëm që duhet të deklarohet, por edhe shfaqet në mënyrë të qartë, që ajo të jetë lëvizja më interesante dhe më e ndërlikuar fashiste, sepse si formacionet gjeologjike paraqet shtresa të mbivendosura ajo paraqet njëherësh si tipare parafashiste, ashtu edhe karakteristike fashiste radikale.”*

Nga Ernst Nolte – historian dhe filozof gjerman

Në cilin vend u themelua dhe veproi organizata ultranacionaliste dhe antisemite për të cilën flitet në dokumentin e mësipërm:

1 pikë

- A) Hungari
- B) Kroaci
- C) Rumani
- D) Bullgari

12. *Në fund të viteve '20 vihet re një ulje e tensionit në politikën evropiane dhe një funksionim më i mirë i sigurisë kolektive. Kjo atmosferë gjeti jehonë edhe në Ballkan ku u bënë përpjekje për arritjen e marrëveshjes me karakter rajonal.*

Identifiko faktorin kryesor që nxiti organizimin e katër konferencave ballkanike gjatë viteve 1930-1934:

1 pikë

- A) Nënshkrimi i Paktit Kellog-Briand
- B) Vullneti i mirë i vendeve ballkanike
- C) Ndikimi italian në krijimin e një aleance ballkanike
- D) Interesimi i drejtpërdrejtë i Britanisë së Madhe

13. *“Asnjë kishë apo famulli e Francës dhe asnjë qytetar francez nuk mund ta pranojnë në asnjë rast, ose me ndonjë pretekst të çfarëdo, autoriteti i një peshkopi të zakonshëm ose i një kryepeshkopi, posti i të cilit do të jetë nën epërsinë e një fuqie të huaj, as atë të përfaqësuesve të saj që banojnë në Francë ose gjetkë; pa paragjykuar, sidoqoftë, uniteti i besimit dhe*

marrëdhënia që do të mbahet me kokën e dukshme të Kishës universale, siç parashikohet më tej.”

Titulli I, pika IV e Kushtetutës Civile të Klerit

- a) Identifiko ngjarjen historike që shërbeu si shtysë për miratimin e aktit ligjor të mësipërm.

1 pikë

- b) Shpjego përmbajtjen e këtij akti.

2 pikë

- c) Cili ishte qëndrimi i peshkopëve francezë kundrejt këtij procesi?

1 pikë

14. *Shek.XIX shënoi një periudhë rënie progresive të Perandorisë Osmane në të gjitha pikëpamjet. Kjo rënie nxiti dhe intensifikoi edhe përplasjet mes Fuqive të Mëdha për influencë mbi territoret e kontrolluara prej saj. Ballkani ishte një ndër arenat kryesore ku këto përplasje u materializuan në formë të qartë.*

- a) Shpjegoni konceptin “pansllavizëm”

1 pikë

- b) Analizo tri qëllimet strategjike të Rusisë në Ballkan, në kushtet e Çështjes Lindore (shek. XVIII – fillim shek, XIX).

3 pikë

- c) Shpjego pozicionin e Perandorisë Habsburge në Ballkan dhe arsyet e përplasjes së saj me Rusinë.

3 pikë

15. *“Lufta për të përcaktuar programin e Lidhjes së Prizrenit, filloi qysh të nesërmen e thellimit të saj dhe vazhdoi më tepër se tri javë. Gjatë këtyre tri javëve mbledhjet qenë të vazhdueshme. Ato pezulloheshin në mbrëmje, por punimet nuk ndërpriteshin. Natën delegatët mbledheshin grupe-grupe, sipas rrymave, në vende të ndryshme, në shtëpitë ku u qenë caktuar për strehim. Sipas traditës popullore, delegatë të rrymës revolucionare mbledheshin në shtëpinë e patriotit prizrenas, Shuajip Spahiut, kurse delegatët sulltanistë në ndërtesën qeveritare, si mysafirë të mytesarifit të Prizrenit, Qamil beut. Duket se patriotët e moderuar nuk kishin një seli të veçantë për mbledhjet e tyre, por duke e konsideruar veten si ndërmjetës, ata takoheshin herë me njëri, herë me tjetrin palë. Mbledhjet e patriotëve radikalë qenë të fshehta. Të fshehta qenë edhe takimet e sulltanistëve, me ndryshim se në mbledhjet e tyre merrnin pjesë funksionarë të vilajetit dhe të mytesarifit.”*

(nga kronikat e kohës)

Evidentoni tri rrymat që u shfaqën në gjirin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit duke shpjeguar dhe qëndrimet e tyre respektive:

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

16. *Periudha mes dy luftërave botërore u karakterizua nga një varësi e fortë ekonomiko-financiare e Shqipërisë prej Italisë. Nga ana tjetër, në vitet '30, mbreti Zog bëri disa herë përpjekje për të gjetur partner të rinj ekonomikë dhe tregtarë.*

- a) Cili ishte vendi ballkanik, të cilit ju drejtua Shqipëria për bashkëpunim ekonomik në fillimin e viteve '30?

1 pikë

- b) Jep arsyen e këtij ndryshimi në qëndrimin e Shqipërisë.

1 pikë

- c) Analizo përse tentativa nuk pati sukses duke e detyruar Shqipërinë t'i rikthehej lidhjeve me Italinë fashiste: **1 pikë**
-

17. *“Kushtetuta e Mbretërisë (SKS) u votua në 28 qershor 1921 në Vidovdan, prej nga mori edhe emrin – Kushtetuta e Vidovdanit. E frymëzuar nga kushtetuta e Serbisë së paraluftës, ajo karakterizohej nga tendenca thellësisht centralizuese, me një mbret shef të ushtrisë që zgjidhte kryeministrin, me një dhomë të vetme në parlament, Skupstina, dhe një administratë krejt në dorë të qeverisë. Për këto arsye, projekti i Kushtetutës, i propozuar nga Partia Radikale e Pashiqit, u rrëzua 10 herë nga Stjepan Radiçi, kryetar i Partisë Fshatare kroate...”*

Nga “Historia e Ballkanit” e Georges Castellan, 1996

- a) Analizo qëndrimet e rrymave kryesore politike që u ballafaquan që në fillim të jetës së Mbretërisë SKS: **2 pikë**
-
-

- b) Cila ishte çështja kryesore e jetës së brendshme të Jugosllavisë që me krijimin e saj?

1 pikë

18. *Duçja vendos të shpejtojë kohën për çështjen shqiptare dhe vetë harton një projekt marrëveshje shumë të shkurtër, me tre artikuj të thatë. Projekti ka më shumë formën e një dekreti se sa të një pakti ndërkombëtar. Po përgatis edhe unë një... Është një akord që, duke ruajtur format, pranon një aneksim efektiv të Shqipërisë. Duçja e miratoi. Ose Zogu pranon kushtet e parashtruara prej nesh, ose ne ndërmarrim pushtimin ushtarak të vendit”*

Nga Ditari i Galeaco Ciano – ministri i jashtëm i Italisë në periudhën fashiste
Identifiko tri nga masat e propozuara nga Çiano në vitin 1938, për parapërgatitjen e kushteve për pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste: **3 pikë**

- a) _____
- b) _____
- c) _____

Skema e vlerësimit

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 8	9 - 13	14 - 18	19 - 22	23 - 28	29 - 32	33 - 35

LËNDA: HISTORI
KLASA: XII
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI

TEST PËR PERIUDHËN E TRETË

Tabela e specifikimeve (BLUE PRINT)

Tematika dhe Tema	Rezultatet e të nxënit	Peshat %	Pikët	N.2 40%	N. 3 40%	N. 4 20%
TEMATIKA 5 Periudha bashkëkohore (1919 deri më sot)	Nxënësi:	100%	35	14	14	7
Diplomacia gjatë Luftës së Dytë Botërore deri më 1946	- analizon vendimet e konferencave kryesore të Aleateve të Mëdhenj, të zhvilluara gjatë luftës dhe shpjegon ndikimin e tyre në Botën e Pasluftës;			1	1	
Fillimet e Luftës së Ftohtë	- përshkruan ndarjen politiko-ideologjike të Europës në përfundim të Luftës së Dytë Botërore; - ballafaqon përplasjen e interesave të ish-Aleatëve të Luftës së Dytë Botërore në Europë, si dhe tregon ngjarjet fillestare të këtyre përplasjeve;			2	1	
Krijimi i Bllokut Perëndimor	- evidenton ndryshimin e fuqisë dhe balancave mes shteteve të Europës Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore; - vë në dukje gjendjen e vështirë të pasluftës në Europë, përpjekjet për tejkalimin e				3	

	saj dhe nevojën për krijimin e një aleance politiko-ushtarake transatlantike;					
Shqipëria dhe marrëdhëniet e saj me Perëndimin.	- analizon qëndrimet e anglo-amerikanëve ndaj qeverisë shqiptare të drejtuar nga Enver Hoxha dhe kërkesat e tyre për legjitimimin e sistemit me anë të zgjedhjeve të lira; - evidenton arsyet e prishjes së marrëdhënieve të qeverisë komuniste shqiptare me Britaninë e Madhe dhe ShBA-në;			2		
Krijimi i Bllokut Lindor	- përshkruan vendin që zinte Europa Lindore e Qendrore në synimet gjeostrategjike të Bashkimit Sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore; - shpjegon taktikat dhe rrugët e përdorura nga Bashkimi Sovjetik për vendosjen e regjimeve komuniste në Europën Lindore;			1	1	
Shqipëria dhe Jugosllavia 1944–1948	- analizon format dhe metodat e përdorura prej jugosllaveve për vendosjen e kontrollit të tyre në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948; - argumenton rolin e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në prishjen e marrëdhënieve Shqiptaro-Jugosllave;				2	1
Shqipëria dhe BRSS 1948–1961.	- tregon ndryshimet e ndodhura në BS pas				3	


	vdekjes së Stalinit dhe shpalesjes së Kursit të Ri të Hrushovit, duke evidentuar ndikimin e tyre në politikën shqiptare; - shpjegon zhvillimet në Konferencën III- të PPSH-së për Tiranën dhe gjykon mbi domethënien e saj për të ardhmen e Shqipërisë;					
Marrëdhëniet ndërmjet dy blloqeve (1950–1980.	- shpjegon rrjedhojat e përplasjeve mes blloqeve në arenën ndërkombëtare; - vë në dukje momentet më të tensionuara të Luftës së Ftohtë; - arsyeton mbi konfliktin në fushën ideologjike mes blloqeve dhe pasqyrimin e tij nëpërmjet propagandës;			2		
Kina brenda dhe jashtë Blloqeve të Luftës së Ftohtë.	- evidenton veçantitë e komunizmit kinez;					2
Shqipëria dhe Kina (1961–1978)	- analizon raportet shqiptaro-kineze dhe identifikon arsyet e forcimit të tyre, sidomos në vitet’60 të shekullit XX; - vë në dukje bashkëpunimin ekonomik dhe ndihmën kineze për zhvillimin e Shqipërisë; - shpjegon reflektimin e Revolucionit të Madh Kulturor kinez në Shqipëri;					
Zhvillimet brenda blloqeve: Blloku Lindor	- shpjegon format dhe instrumentet e kontrollit të Bllokut			5		3

	Lindor nga ana e BS-së duke dalluar mes atyre politike, ekonomike dhe ushtarake;					
Zhvillimet brenda blloqeve: Blloku Perëndimor	- evidenton arsyet e zhvillimit të shpejtë ekonomik dhe shoqëror të Europës Perëndimore në periudhën e pasluftës;				3	
Vetizolimi i Shqipërisë	- analizon karakterin autokratik të shtetit komunist dhe pasojat e vetizolimit në jetën dhe ekonominë e vendit;			1		
Shqipëria në tranzicion	- analizon tiparet e transformimit ekonomiko-shoqëror të Shqipërisë gjatë tranzicionit; - gjykon mbi arritjet dhe dështimet e tranzicionit në Shqipëri.					1

LËNDA: HISTORI
KLASA: XII
SHKOLLA: NEW YORK
MËSUES: ANILA BESHAI
PERIUDHA E TRETË

1. Jo, Franca nuk do të jetë një vend i kolonizuar! Amerikanët në Amerikë!

Poster i publikuar nga Partia Komuniste Franceze



Qëndrimi i paraqitur në poster, duket i ndikuar më pak nga cila prej ngjarjeve të mëposhtme?

1 pikë

- A) Krijimi i Kombeve të Bashkuara
 - B) Shpallja e Planit Marshall nga SHBA
 - C) Krijimi i Tregut të Përbashkët Evropian
 - D) Krijimi i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
2. Bashkëpunimi i kohës së luftës mes Bashkimit Sovjetik dhe vendeve perëndimore ishte tronditur tashmë seriozisht në Konferencën e Potsdamit në korrik-gusht 1945 sepse: **1 pikë**
- A) për shkak të politikave toleruese të Ruzveltit ndaj Stalinit në këtë konferencë
 - B) Uinston Çurchill i kishte prishur marrëdhëniet me presidentin Truman
 - C) Sovjetikët ishin tërhequr nga premtimi i tyre për të hyrë në luftë kundër Japonisë
 - D) Stalini kishte nisur të krijonte bazat e kontrollit sovjetik mbi Evropën Lindore.

3. *“Lufta Nacionalçlirimtare i dha popullit shqiptar një fitore tjetër të madhe, aleancën e pavdekshme që do të rrojë sa të jetë jeta, me popujt e Jugosllavisë së re të marshallit Tito. As nuk mund të zhvillohej lufta jonë në atë mënyrë si u zhvillua, pa mbështetjen, përkrahjen e madhe të popujve vëllezër të Jugosllavisë së re...Populli ynë kishte fatin e madh të kishte në kufi të veriut një aleat të fuqishëm dhe besnik që e shpëtoi atë nga rreziku, që e ndihmoi në rrezikun më të madh dhe që lidhi me të përjetë fatet e tij.”*

Gazeta Bashkimi, 29 nëntor 1947

Gjatë Luftës së Dytë Botërore Jugosllavia:

1 pikë

- A) dërgoi dy divizione në ndihmë të partizanëve shqiptarë;
- B) i dha Shqipërisë ndihma të konsiderueshme materiale;
- C) ndihmoi Shqipërinë në lidhjet me vendet perëndimore;
- D) pranoi kontributin e forcave partizane shqiptare për çlirimin e saj.

4. Firmosja e armëpushimit mes palëve ndërluftuese në Luftën e Koresë (1950-1953) çoi në:

1 pikë

- A) ndarjen e Koresë së Veriut dhe asaj të Jugut përgjatë paralelit 38;
- B) krijimin e një qeverie komuniste në Korenë e Jugut;
- C) eliminimin e frikës së komunizmit në SHBA;
- D) marrjen e kontrollit nga Kina të gjithë gadishullit Korean.

5. Cila ishte arsyeja kryesore që Polonia, Çekosllovakia, Hungaria dhe Rumania u bënë satelitë të Bashkimit Sovjetik?

1 pikë

- A) Këto zona ju dhanë Bashkimit Sovjetik si mandate të Kombeve të Bashkuara
- B) Popullsia e çdo vendi votoi lirisht për t'u bërë aleatë të Bashkimit Sovjetik
- C) Ushtria sovjetike i pushtoi këto territore në përfundim të Luftës së Dytë Botërore
- D) Hitleri ja dha kontrollin e këtyre zonave Bashkimit Sovjetik në përfundim të luftës

6. Identifikoni një nga synimet e Bashkimit Sovjetik në krijimin e Bllokut Lindor:

1 pikë

- A) tërheqjen e ushtrisë sovjetike nga vendet e Bllokut;
- B) krijimin e një zone mbrojtëse “kushinetë” në kufijtë perëndimorë të BS;
- C) zgjerimi i lirive individuale në vendet anëtare të tij;
- D) tërheqja e investimeve të huaja perëndimore direkt përmes tij.

7. Cila krizë i çoi Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në prag të luftës bërthamore në 1962? **1 pikë**

- A) Një përpjekje nga udhëheqësit komunistë në Hungari për t’u tërhequr nga Traktati i Varshavës.
- B) Krijimi i Gjermanisë Lindore si një njësi e veçantë mbi bazën e zonës sovjetike të kontrollit.
- C) Një pushtim i Koresë së Jugut nga forcat e armatosura komuniste të Koresë së Veriut.
- D) Vendosja në Kubë e raketave sovjetike me rreze të mesme veprimi.

8. Bashkimi Sovjetik dhe vendet e Bllokut Lindor i përdorën planet pesëvjeçare për të:

1 pikë

- A) Koordinuar veprimet me vendet europiano-perëndimore në kuadër të OSBE-së
- B) Zhvilluar një bashkëpunim më të ngushtë ushtarak mes vendeve europiano-lindore
- C) Konceptuar dhe zbatuar politikat ekonomike lidhur me prodhimin bujqësor dhe industrial
- D) Funkcionuar si kufij kohorë për ndryshimin e udhëheqjes politike

9. Identifikoni cila prej masave të mëposhtme i takon fazës së parë të drejtimit të vendit, nga Ramiz Alia: **1 pikë**

- A) ndalimi i internimeve për krimet politike;
- B) lejimi i marrjes së huave dhe kredive nga jashtë;
- C) lejimi i ushtrimit të lirisë së besimit;
- D) zhvendosja e prioritetit drejt industrisë së lehtë dhe ushqimore.

10. Cila nga masat e mëposhtme, të ndërmarra me ardhjen e demokracisë në Shqipëri, është pjesë e ndërtimit të Shtetit të së Drejtës? **1 pikë**

- A) Privatizimet masive në çdo aspekt
- B) Liberalizimi i çmimeve në përgjithësi
- C) Hartimi dhe miratimi i një legjislacioni të ri
- D) Vendosja e marrëdhënieve tregtare të hapura me cilindo vend

11. *"Duhet të them se situata botërore është shumë serioze. . . . Europa duhet të ketë shumë ndihmë shtesë ose do të përballlet me dëme të rënda ekonomike, sociale dhe politike. Kjo do të kishte një efekt të dëmshëm për botën në përgjithësi. Ka edhe mundësi për trazira për shkak të dëshpërimit të njerëzve në fjalë. Efekti mbi ekonominë e Shteteve të Bashkuara duhet të jetë i qartë për të gjithë. Pra, Shtetet e Bashkuara duhet të bëjnë ç'të munden për të ndihmuar në rivendosjen e shëndetit normal ekonomik në botë. Pa këtë nuk mund të ketë stabilitet politik apo paqe. Politika jonë është e drejtuar. . . kundër urisë, varfërisë, dëshpërimit dhe kaosit. Qëllimi i tij është të ringjallë ekonominë e punës në botë ".*

Kjo pjesë është marrë, e përshtatur, nga një fjalim i Sekretarit Amerikan të Shtetit Xhorxh Marshall në 5 qershor 1947. Në të, ai shpjegon planin e tij për rimëkëmbjen e Europës.

- a) Jepni një nga arsyet që e shtynë Sekretarin e Shtetit Xhorxh Marshall të bënte këtë propozim. **1 pikë**

- b) Analizoni shkurt, cilat ishin përfitimet e SHBA nga zbatimi i këtij plani. **3 pikë**

12. SHBA dhe Britania e Madhe e përshëndetën dhe e përkrahën rezistencën e popullit shqiptar kundër nazifashizmit. Megjithatë ato nuk e njohën zyrtarisht qeverinë shqiptare të Enver

Hoxhës pas luftës. Marrëdhëniet mes tyre u përkeqësuan deri në atë pikë sa ato u prishën përfundimisht dhe mbetën të tilla për disa dekada.

Shpjegoni tri shkaqe që çuan në prishjen e marrëdhënieve mes qeverisë shqiptare me SHBA dhe Britaninë e Madhe.

3 pikë

SHBA	Britania e Madhe

13. Jepni instrumentet përmes së cilave Bashkimi Sovjetik realizonte kontrollin mbi vendet e Evropës Lindore në planin:

3 pikë

- a) politik; _____
- b) ekonomik; _____
- c) ushtarak; _____

14. *“Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik e dënoi me të drejtë kultin e individit të krijuar nga Stalini në vitet e fundit të aktivitetit të tij që i solli kaq dëm Bashkimit Sovjetik. Është detyrë e përhershme e Partisë sonë të luftojë kultin e individit në çdo formë që të shfaqet ai, për të vendosur kolegjalitetin si parim udhëheqës të partisë... E rëndësishme është që çdo anëtar partie të kuptojë se në parti nuk mund të ketë frikë... Çdo anëtar partie të shprehë në parti mendimin e të kritikojë me forcë të metat në punë dhe ata që janë përgjegjës për këto të meta...”*

“Marksizëm-leninizmi mëson se populli është krijuesi i historisë” –
 artikull në gazetën “Zëri i Popullit” shkruar nga Enver Hoxha


- a) Identifikoni ngjarjen për të cilën flitet në dokumentin e mësipërm:

1 pikë

- b) Jepni dy prej kërkesave sovjetike, drejtuar udhëheqjes shqiptare në kuadër të liberalizimit politik pas ngjarjes në fjalë: **2 pikë**

- c) Analizoni ngjarjen ku u pasqyrua drejtpërsëdrejti ndikimi i kësaj procesi liberalizues në skenën politike të Shqipërisë komuniste: **2 pikë**

15. Duke krahasuar revolucionin hungarez të vitit 1956 dhe ngjarjet e “Pranverës së Pragës” 1968, identifikoni një të përbashkët dhe dy të veçanta mes tyre: **3 pikë**



16. "Ajo që Mao kishte në mendje ishte një shoqëri plotësisht e pastër, e lirë nga qytetërimi, i privuar nga përfaqësimi i ndjenjave njerëzore e banuara nga një tufë pa ndjeshmëri, që automatikisht do t'u bindeshin urdhrave të tij. Është sugjeruar që, ashtu si shumë perandorë të së kaluarës, Mao po kërkonte pavdekësinë duke identifikuar veten me simbole që do të

jetonin pas tij. Kultin e Maos ishte në thelbin e lëvizjes. Pothuajse të gjithë kishin rezerva për politikën e tij nga Politburo poshtë. Mao kishte frikë se kishte një komplot kundër tij duke përfshirë udhëheqë të lartë në bashkëpunim me rusët. Në nëntor të vitit 1965, Mao ishte i gatshëm të niste “Pastrimin e Madh” ”për të ndëshkuar këtë partinë tonë”, siç e tha ai. Libri i Kuq i Maos ju shpërnda të gjithëve dhe në qershor 1966 Mao intensifikoi terrorizimin e shoqërisë, duke zgjedhur si instrumentin e tij të parë të terrorit të rinj në shkolla dhe universitete.

H. Chang & J. Halliday, *Mao: Historia e panjohur*, botuar në 2007

Mbështetur në dokumentin e mësipërm:

a) Shpjegoni dy shkaqe përse ndodhi Revolucioni i Madh Proletar Kulturor në Kinë. **2 pikë**

b) Cili ishte thelbi i këtij revolucioni? **1 pikë**

17. “Synimi i jugosllavëve ishte kthimi i Shqipërisë në një republikë të 7-të të Jugosllavisë”

Nga libri i Enver Hoxhës “Titistët”

Nisur nga konteksti historik i periudhës 1945-1948, a jeni dakord me pohimin e mësipërm?
Jep dy argumente që prekin aspekte të ndryshme për përgjigjen tënde. **2 pikë**

18. Tri dekadat pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ishin një periudhë zhvillimi i vrullshëm ekonomik dhe rritje e nivelit të mirëqenies për vendet e Bllokut Perëndimor, të njohura si “Vite të Lavdishme”.

Identifikoni dy prej faktorëve që ndikuan në zhvillimin ekonomik të vendeve të Europës Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore: **2 pikë**

Skema e vlerësimit

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 - 8	9 - 13	14 - 18	19 - 22	23 - 28	29 - 32	33 - 35